2020

RAPORTI VJETOR

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

RAPORTI VJETOR

TRYEZA E LËNDËS

Hyrje 4

1. Mesazhi 8
2. Kuadri ligjor 12
3. Respektimi dhe plotësimi i detyrimeve ndërkombëtare, Përmbushja e rekomandimeve të “Progres Raportit“ të BE-së për Shqipërinë 15
4. Zbatimi i rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së AIDSSH-së për vitin 2020 20
5. Veprimtaria e AIDSSH-së për vitin 2020 31
6. Detyrime ligjore nga AIDSSH dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar 76
7. Ndryshimet në kuadrin rregullator për vitin 2020 dhe efektet e tyre 78
8. Mbi problematikat e ndeshura në veprimtarinë e AIDSSH-së me qëllim gjetjen e rrugëve më efikase për zgjidhjen e tyre nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave 81
9. Ndryshimet në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e AUTORITETIT dhe impakti i tyre 86
10. Organizimi i brendshëm i institucionit 90
11. Proceset gjyqësore ku institucioni ka qenë palë në proces 103

H Y R J E

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) është institucion i pavarur, i krijuar me ligjin nr. 45/2015 *"Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë",* për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar. Në vitin 2020, ligji funksional pësoi ndryshime që përmirësuan kuadrin ligjor të veprimtarisë së institucionit, sa i takon informimit, hulumtimit shkencor, edukimit qytetar dhe kontributit për të zhdukurit në komunizëm.

Raporti vjetor i punës 2020 është hartuar dhe miratuar në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, që normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit.

Në një vit pandemie dhe post-tërmeti, faktorë që ndikuan ndjeshëm aspekte të veprimtarive të përditshme, institucioni gjeti zgjidhje të përshtatshme duke vijuar punën me organizimin e të dhënave arkivore dhe sigurimin e aksesit në to, në koordinim të të gjitha drejtorive dhe sektorëve. Mbajtja e komunikimit aktiv online me të interesuarit ruajti prirjen e kërkesave për informim, çoi në nënshkrimin e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit, punë koordinuese për të zhdukurit në komunizëm

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) është institucion i pavarur, i krijuar me ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

dhe për përkujtimin e nderimin e viktimave e të dënuarve të ndërgjegjes.

30 vjet pas ndryshimeve demokratike në vend, - në respekt të vlerave europiane e properëndimore, rezolutave kombëtare dhe ndërkombëtare për trashëgiminë historike, - Autoriteti u mbështet me ekspertizë nga institucionet homologe ndërkombëtare të kujtesës, mes të cilave ENRS (ku Shqipëria u paraqit duke angazhuar edhe Ministrinë e Kulturës), Rrjeti Europian i Arkivave të ish-Policive Sekrete, IPN polake me studimet shkencore dhe përvojën me të zhdukurit, ICMP dhe BE për të zhdukurit në komunizëm, dhe përfaqësi të huaja në vend, të interesuara të kontribuojnë në proceset koordinuese të drejtësisë tranzitore.

01.

MESAZHI

Vlerat demokratike të drejtësisë, së vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për brezat e ardhshëm, në funksion të informimit dhe edukimit të shoqërisë çuan në krijimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në vitin 2017.

Sot, katër vjet më pas, Autoriteti mund të bëjë një bilanc të veprimtarisë, mes sfidave dhe arritjeve në përballjen me të shkuarën e afërt, shërbimin e dokumentacionit të prekurve, familjarëve, institucioneve të drejtësisë, atyre publike dhe të pavarura, studiuesve dhe mediave, hulumtimin shkencor dhe edukimin qytetar, shkëmbimet me partnerët në vend dhe ata ndërkombëtarë, përvojën e mbledhur dhe synimet për të ardhmen.

Autoriteti e filloi 2020 me pjesëmarrje në takimin e përvitshëm të ENRS, Rrjeti Europian i Kujtesës dhe Solidaritetit, - ku Shqipëria përfaqësohet nga viti 2015, - dhe e mbylli me anëtarësimin me të drejta të plota në Rrjetin Europian të Arkivave të ish-Policive Sekrete, përvojë nga e cila pritet të përfitojë dhe të konsolidojë bashkëpunimet me institucionet e vendeve anëtare.

2020 është viti i ndryshimeve ligjore të miratuara në Kuvend, që garantojnë vijimësinë e verifikimit të kandidatëve dhe figurave në institucionet e larta shtetërore, në organet e vetingut në drejtësi dhe të policisë si një ndër hallkat e sistemit të drejtësisë.

Po ashtu, zgjerimi i fushave të bashkëpunimit në kuadër të mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar për demokraci, ndihmon në pozicionimin e Autoritetit brenda një

Autoriteti mund të bëjë një bilanc të veprimtarisë, mes sfidave dhe arritjeve në përballjen me të shkuarën e afërt, shërbimin e dokumentacionit të prekurve, familjarëve, institucioneve të drejtësisë, atyre publike dhe të pavarura, studiuesve dhe mediave, hulumtimin shkencor dhe edukimin qytetar, shkëmbimet me partnerët në vend dhe ata ndërkombëtarë, përvojën e mbledhur dhe synimet për të ardhmen.

peizazhi më të gjerë akademik vendas dhe ndërkombëtar.

Të zhdukurit në komunizëm dhe qartësimi i fatit të tyre, në koordinim me institucionet e tjera në vend, janë një tjetër pikë e rëndësishme e ndryshimeve ligjore të miratuara, që u hapën udhë proceseve bashkërenduese ndërinstitucionale me familjet.

Sot, të gjitha vendimet e Autoritetit mbi kandidatët dhe zyrtarët e verifikuar, kërkesat individuale, institucionale, studimore dhe mediatike, publikohen periodikisht në letër dhe në faqen zyrtare, si dhe shpërndahen gjerësisht online. Po ashtu, Autoriteti funksionon si platformë shërbimesh për kërkesat për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi, për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, etj.

Autoriteti gjatë vitit 2020 është investuar në 76 mbledhje të tij, ku janë marrë 726 vendime (nga të cilët 716 vendime unanime), **214** kandidatë apo zyrtarë janë verifikuar, kanë përfunduar procedurat për **509 kërkesa individuale**, për **99** kërkesa janë mbyllur procedurat lidhur me faktin e qenies në internim për motive politike të kërkuesve për efekte pensioni, **120** kërkesa studimore e mediatike të përfunduara me **451** dosje të trajtuara, **52.867** dokumente të deklasifikuar, **12.0478** fletë dokumente arkivore të digjitalizuara, u nënshkruan 6 marrëveshje bashkëpunimi, u zhvilluan takime shkencore me prani ndërkombëtare dhe ekspozita me materiale arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, dolën në dritë botime të studimeve dhe disa projekte u iniciuan, pavarësisht një viti të pazakontë pandemie dhe kufizimesh.

Mbledhja në një arkiv të vetëm, me rëndësi për trashëgiminë historike kombëtare, e të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sfidë disavjeçare e Autoritetit, çoi në transferimin e një pjese të dokumenteve të ish-Ministrisë së Brendshme në ndërtesën aktuale të institucionit.

Edhe përgjatë 2020, Autoriteti ushtroi funksionet në ndërtesën e përkohshme pranë Gardës së Republikës. Arkivi në dy godina të ndryshme vijoi të krijonte situatë të vështirë



sa i takon shërbimit të qytetarëve, kushteve të përshtatshme të punës dhe studimit, shërbimit të dokumenteve arkivore dhe vënies në dispozicion në kohë të shkurtër. Edhe situata e ndërtesave arkivore pas tërmetit të nëntorit 2019, ndikoi në paralizimin e lëvizjes në fondin e dokumenteve pranë IPQP, ndërtesë e dëmtuar ndjeshëm, duke krijuar pamundësi për shërbim të dokumenteve qytetarëve e studiuesve, si edhe salla kryesore e Autoritetit, e papërdorshme për funksionet e institucionit: mbledhje Autoriteti, takime me grupet e interesit, seminare, ekspozita dokumentare, etj. Marrëveshja me Qeverinë Suedeze për krijimin e kushteve dhe standardeve bashkëkohore të punës, përfshirë shërbimet e integruara TIK kaloi disa faza të zbatimit, prokurimeve dhe firmosjes së kontratës me fituesit e fazës së parë të rikonstruksionit, që do të krijojnë kushtet për zhvendosjen e veprimtarisë së Autoritetit në ndërtesën e re, përgjatë vitit 2021.

Strukturë/organika e miratuar nga Kuvendi u arrit deri në 77 % gjatë 2020 dhe pritet të plotësohet në 2021, me 60 punonjësit e miratuar që në krijimin e Autoritetit sipas strukturë/organikës së saj. Stafi i paplotë ka sjellë radhë të gjata, ka rritur kohën e pritjes për marrje shërbimesh nga subjektet kërkuese dhe ka pasur ndikim të ndjeshëm në proceset e përditshme të punës.
Me fuqizimin e Autoritetit, sipas modelit të homologëve, - si institucion për informimin e individëve, familjeve, studiuesve e mediave i cili, në bashkëpunim me partnerë, kryen veprimtari hulumtuese dhe të kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe edukimit qytetar, duke trajtuar me përgjegjësi materialet arkivore të rëndësisë së veçantë që administron prej 2017, që përkujton dhe nderon personalitetet e ngjarjet historike, koordinon çështjen e të zhdukurve në komunizëm, publikon dhe shpërndan në platforma zyrtare e sociale artikuj shkencorë e botime cilësore mbi të shkuarën, në ndihmë të shoqërisë e brezave të rinj, - rritet përgjegjësia dhe pritshmëritë për informimin e shoqërisë dhe nxitjen e dialogut qytetar për demokraci.

Strukturë organika



02.

KUADRI LIGJOR

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si organ i lartë shtetëror, i pavarur, i ngarkuar për administrimin e procesit të informimit për dokumentet e ish–Sigurimit të Shtetit, për realizimin e misionit të vet, udhëhiqet nga parimet e pajtimit dhe unitetit kombëtar, transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si organ i lartë shtetëror, i pavarur, i ngarkuar për administrimin e procesit të informimit për dokumentet e ish–Sigurimit të Shtetit, për realizimin e misionit të vet, udhëhiqet nga parimet e pajtimit dhe unitetit kombëtar, transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore.

Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"; ligji nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë; ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; ligji nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme"; ligji nr.7514, datë 30.9.1991"Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar; ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; ligji nr. 152, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", në *akte nënligjore* të nxjerra në bazë dhe për zbatim

të ligjit organik, si: Vendimi i Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"; VKM nr. 98, datë 15.02.2017, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike"; VKM nr. 935, datë 28.12.2016, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të objektit nr. 52, me emërtim "Arkivi i Ri", brenda Territorit të Pronës nr. 12, me emërtimin "Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes", VKM Nr.93, datë 27.02.2019, "Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", etj; si dhe,

në Rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar me vendimin e Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017, dhe një sërë aktesh të tjera rregullatore që normojnë veprimtarinë e institucionit. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Autoriteti ndihmohet nga Sekretariati Teknik.

03

RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË "PROGRES RAPORTIT" TË BE-SË PËR SHQIPËRINË

Shqipëria është angazhuar për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, nëpërmjet ratifikimit të traktateve ndërkombëtare e rajonale dhe përfshirjes së saj në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara 2030

Detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria është angazhuar për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, nëpërmjet ratifikimit të traktateve ndërkombëtare e rajonale dhe përfshirjes së saj në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara 2030. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Civile dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut njohin barazinë përpara ligjit dhe elementë të tjerë kyç që forcojnë sistemin e drejtësisë.

Autoriteti e filloi veprimtarinë e vet në 2017, në frymën e rezolutave ndërkombëtare që kanë trajtuar trashëgiminë e së shkuarës, si Rezoluta e Parlamentit Europian "Mbi ndërgjegjen europiane dhe totalitarizmin" (2009), Deklarata e Pragës "Mbi ndërgjegjen europiane dhe komunizmin" (2008), Rezoluta 1096 (1996) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës "Masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste", si dhe Rezoluta 1481 (2006) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste"; të njohura nga Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të të cilave janë miratuar Rezoluta nr.11 "Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri" (2006) dhe Rezoluta "Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut" (2016), pas miratimit të ligjit nr.45/2015, i ndryshuar.

Rezoluta më e fundit ndërkombëtare mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, u miratua në shtator 2019 nga Parlamenti Europian, duke shprehur respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare, mbështetje për përkujtimin dhe shqetësimin për përdorimin e simboleve të regjimeve dhe glorifikimin e tyre. Duke pasur parasysh që kujtimet e së kaluarës tragjike të Europës duhet të mbahen gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të shtrohet rruga për pajtim, bazuar tek e vërteta dhe përkujtimi, rezoluta e PE thotë se kujtimi i viktimave të regjimeve totalitare, sikundër njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste dhe të tjera, kanë rëndësi jetike për unitetin e Europës.

Kombet e Bashkuara

Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, me objektivin 16, të zhvillimit të qëndrueshëm, synon shoqëri gjithëpërfshirëse dhe që jetojnë në paqe, institucione efektive e të besueshme dhe akses në drejtësi, si elementë thelbësorë për zhvillimin. Në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2020, Autoriteti ka kontribuar në përmbushjen e rekomandimeve të Grupit të Punës të OKB-së për Personat e Zhdukur (WGEID), ku Kombet e Bashkuara pohojnë për Shqipërinë se, forcimi i ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në institucionet e drejtësisë dhe përmirësimit të proceseve të drejtësisë tranzicionale, ndihmon sigurimin e së vërtetës, e ridimensionon atë dhe u jep zë viktimave, elemente që vënë themelet për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe në shoqëri.

"Pa paqe, stabilitet, respektim të të drejtave të njeriut dhe qeverisje efektive, të mbështetur në sundimin e ligjit, nuk mund të shpresohet për zhvillim të qëndrueshëm, në një botë me shoqëri të polarizuar, ku vijojnë ciklet e konflikteve dhe dhunës. Secila prej tyre duhet trajtuar dhe zgjidhur, si bashkëpunim i institucioneve me komunitetet, duke mbrojtur më të dobëtit, forcuar zbatimin e ligjit dhe mbështetur respektimin e të drejtave të njeriut, si elementë kyç të procesit". Kontributi i Autoritetit në përmbushje të misionit për mbrojtjen e interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe unitetit kombëtar, ligjshmërisë, informimit të publikut me informacionin zyrtar dhe mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale; në kuadër të transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, në zbatim të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ka qenë i ndjeshëm përgjatë 2020 dhe ilustrohet në raport.

Bashkimi Europian

Në raportin e progresit 2020 të Komisionit Europian për Shqipërinë theksohet rëndësia e proceseve të zbatimit të reformës në drejtësi, në veçanti vlerësimi i figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetingu). Pavarësisht pandemisë, më shumë se 286 dosje funksionarësh janë kaluar nga institucionet e vetingut, ku rivlerësimi i funksionarëve të lartë dhe krijimi i organeve

të sistemit të vetingut ka prodhuar rezultate konkrete dhe të besueshme. Sipas raportit 2020, ka pasur progres, në veçanti në zbatimin e reformës në drejtësi.

Në këtë kuadër, Autoriteti ka detyrimin ligjor të verifikimit të pastërtisë së figurave të zyrtarëve të lartë, të cilët, sipas ligjit, i janë nënshtruar procesit deri në mars 2020, proces ku përfshihen shumë institucione. Vlerësimi i pastërtisë së figurës ka vijuar pas ndryshimeve ligjore të 29 korrikut 2020. 1.840 kandidatë janë verifikuar nga Autoriteti që nga viti 2017, nga të cilët 1.777 e kaluan filtrin si të pastër, ndërsa 63 kandidatë rezultuan në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtorë, ose punonjës të strukturave të ish-Sigurimit, ose anëtarë trupi gjykues në procese politike që lidhen me fushën e veprimit të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Po ashtu, në raportin e progresit 2020, në kapitullin "E drejta për jetën", përmendet marrëveshja e bashkëpunimit e 2018, mes Qeverisë Shqiptare dhe ICMP, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, me të cilin AIDSSH bashkëpunon aktivisht, (aplikacionet e ICMP për të zhdukurit në komunizëm figurojnë që në 2018 në faqen zyrtare të Autoritetit). Marrëveshja u nënshkrua në vijim të rekomandimeve të Grupit të OKB-së për personat e zhdukur (WGEID), u ratifikua në nëntor 2018 nga Kuvendi, duke e lejuar ICMP të fillojë mbledhjen e mostrave të ADN-së, me mbështetje financiare të BE.

Në gusht 2020, Autoriteti dhe ICMP firmosën marrëveshjen teknike të bashkëpunimit nr. 831/11, për projektin "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm", 2020-2021, i mbështetur nga Bashkimi Europian. Projekti po kontribuon në zgjerimin e rolit koordinues të AIDSSH mes institucioneve, pushtetit vendor dhe familjeve, sa i takon çështjes së të zhdukurve gjatë regjimit komunist.

Zbatimi i rekomandimeve nga Autoriteti

Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit gjatë 2020 për të zhdukurit në komunizëm, sipas rekomandimeve të OKB për periudhën



2017-2021, i është dorëzuar MEPJ, që koordinon përmbushjen ndërinstitucionale të rekomandimeve për Grupin e Zhdukjeve me Forcë në Kombet e Bashkuara.

Bazuar në rekomandimet dhe detyrat funksionale që i ngarkon ligji 45/2015 i ndryshuar, Autoriteti është angazhuar aktivisht dhe ka bashkëpunuar me institucione të tjera publike në vend, Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë, Prokurorinë e Përgjithshme, Avokatin e Popullit, Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, Ministrinë e Drejtësisë, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Institutin e Arkeologjisë, pushtetin lokal dhe familjet, me mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, duke dhënë kontribut konkret në sigurimin e informacionit dokumentar të lidhur me ta; po ashtu, në ngritjen e çështjes dhe lobimin me institucione publike e ndërkombëtare për avancim të kërkimeve.

Kuvendi i Shqipërisë, në bazë të ligjit 45/2015, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2020, datë 29.7.2020, e vendosi institucionin e Autoritetit si një nga institucionet shqiptare që japin kontribut për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të zhdukur gjatë komunizmit.

Veprimtaria ligjore e Autoritetit, në bazë të nenit 22/1 të ligjit 45 /2015, i ndryshuar, u përshkallëzua përgjatë 2020, edhe pse vit pandemie, dhe pritet të konkretizohet nëpërmjet marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe me institucionet qendrore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë, të cilat do të kryhen në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, (informacioni i plotë në kapitullin 5 për Zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2020, seksioni për të zhdukurit dhe bashkëpunimin institucional).

04.

ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AIDSSH-SË PËR VITIN 2020

1. ***Të vijojë zbatimin me përpikëri të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" përsa i takon mbledhjes, administrimit, përpunimit, përdorimit dhe informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, duke u udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe të unitetit kombëtar, informimit të publikut me informacionin zyrtar, mbrojtjes së të drejtës për jetë private, dhe të dhënave personale, mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, transparencës, bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, si dhe të eficencës dhe efektivitetit.***

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Autoriteti, edhe pse në kushtet e vështira të krijuara për shkak të pandemisë, ka vijuar pandërprerë punën me proceset që kanë të bëjnë me administrimin, përpunimin, përdorimin dhe informimin në lidhje me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Autoriteti, edhe pse në kushtet e vështira të krijuara për shkak të pandemisë, ka vijuar pandërprerë punën me proceset që kanë të bëjnë me administrimin, përpunimin, përdorimin dhe informimin në lidhje me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. I gjithë procesi për trajtimin e kërkesave për informim nga subjektet e parashikuara në ligjin 45/2015 i ndryshuar, është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë kombëtare, pajtimit dhe të

unitetit kombëtar, informimit të publikut me informacionin zyrtar, mbrojtjes së të drejtës për jetë private, dhe të dhënave personale, mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, transparencës, bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, si dhe të eficencës dhe efektivitetit. Pavarësisht vështirësive të përmendura më sipër, janë marrë masat për ndjekjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore të ligjit 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për punën me informacionin e klasifikuar dhe procesin e deklasifikimit të materialeve arkivore. Me shtimin e kapaciteteve në burime njerëzore (edhe pse akoma nuk janë plotësuar të gjithë pozicionet), sipas organikës së miratuar nga Kuvendi, AIDSSH ka koordinuar më mirë proceset e punës ndërmjet drejtorive, duke rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. E gjithë kjo është përkthyer në numër më të madh vendimesh të marra nga Autoriteti, dokumentesh të deklasifikuara dhe natyrisht, në numër më të madh dokumentesh të vëna në dispozicion për të prekurit, studiuesit, median dhe institucionet publike.

Janë hedhur hapa në ndihmë të mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar, me miratimin e Udhëzuesit për studiuesit dhe mediat, koordinimin për botime mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe buletinët përkatës, kontributin në marrëveshjet institucionale me grupet e interesit për organizimin e aktiviteteve sipas kalendarit të kujtesës dhe për drejtësinë tranzicionale, sa u takon të zhdukurve në komunizëm.

2. ***Të marrë masa për krijimin e një arkivi të vetëm të të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas standardeve përkatëse dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat, duke patur parasysh që ndërtimi dhe organizimi i këtij arkivi është i një rëndësie të veçantë për trashëgiminë historike kombëtare dhe vijon të mbetet një ndër sfidat e rëndësishme të Autoritetit, por edhe detyrim ligjor.***

Nga pikëpamja e infrastrukturës:

Sipas projektit përkatës të financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), "*Rikonstruksioni i godinës së Autoritetit dhe shërbime TIK për krijimin e një arkivi të integruar dhe modern*", janë kryer procedurat e prokurimit në lidhje me blerjen dhe montimin e rafteve të arkivit për vendosjen e dokumenteve. Raftet janë montuar në të katër sallat e arkivit në godinën e re të AIDSSH-së.

Është hartuar dhe miratuar nga Autoriteti dokumenti mbi transferimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, nga ambientet ku ruhen aktualisht për në mjediset e reja të arkivit, si dhe Rregullorja e punës dhe sigurisë në godinën e re.

Nga pikëpamja e pasurisë dokumentare arkivore të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit:

Janë transferuar në godinën e re të Autoritetit dokumentet arkivore që janë marrë në dorëzim nga ASMB, që ruheshin pranë IPQP. Transferimi fizik i dokumenteve është bërë duke respektuar legjislacionin në fuqi për qëllim. Dokumentet janë vendosur në një nga sallat e katit përdhe të godinës, e cila përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet teknologjike të ruajtjes së dokumenteve arkivore, si dhe aspektet e sigurisë.
Mbështetur në ligjin nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, në VKM nr. 98, datë 15.2.2017 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike", Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, kanë vijuar komunikimet institucionale me Ministrinë e Brendshme për dorëzimin e fondeve arkivore të cilat nuk na janë vënë në dispozicion, sipas dispozitave të parashikuara në KREUN III, "Mbledhja e Dokumenteve" të ligjit 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar.
Në këtë kuadër, Autoriteti i është drejtuar disa herë më shkresë zyrtarisht Ministrisë së Brendshme, duke evidentuar mospërmbushjen e detyrimeve sipas akteve të sipërcituara, si dhe ka zhvilluar disa takime ndërmjet titullarëve dhe përfaqësuesve të dy institucioneve.

3. *Të marrë masa për evidentimin, vlerësimin, ruajtjen, përdorimin, shfrytëzimin dhe qarkullimin e dokumentacionit arkivor sipas përcaktimeve të ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", sipas rregullave të përdorimit të dokumentacionit të klasifikuar dhe legjislacionit në fuqi për arkivat.*

Përsa i takon evidentimit, vlerësimit, ruajtjes, përdorimit, shfrytëzimit dhe qarkullimit të dokumentacionit arkivor janë zbatuar me rigorozitetet dispozitat e ligjit 45/2015 i ndryshuar, "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ligjit nr. 9154, datë 11.06.2003 "Për arkivat", ligjit nr.8457, datë 11.2.199, *"Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror""*, i ndryshuar dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor të Republikës së Shqipërisë, si dhe marrëveshjet përkatëse me Ministrinë e Brendshme dhe SHISH-in.
Për trajtimin e dokumentacionit arkivor janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit

8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar, VKM nr. 502, datë 23.06.2010, "Për miratimin e rregullores "Për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", VKM nr. 312, datë 16.03.2011, "Për miratimin e rregullores "Për punën me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", VKM nr. 189, datë 4.03.2015, "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare", VKM nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", VKM nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", dhe akteve të tjera në zbatim të tyre.

4. ***Të hartojë dhe të miratojë rregullat e brendshme. Për këtë qëllim të studiohen praktikat më të mira të institucioneve të huaja homologe, të cilat operojnë me një kuadër të ngjashëm ligjor, por duke mbajtur parasysh faktin që ky dokumentacion përmban të dhëna personale të cilat e bëjnë shumë sensitiv përdorimin e tij.***

Është hartuar një draftrregullore e re, e cila parashikon në mënyrë të detajuar procedurat e ruajtjes, përdorimit, shumëfishimit, përpunimit dhe shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor brenda institucionit. Rregullorja do të kalojë për miratim nga ana e Autoritetit.

Është finalizuar Udhëzuesi për studiuesit e mediat, i miratuar nga Autoriteti me vendimin nr.491, dt. 24/09.2020, për të cilin më herët ka kontribuar edhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Në udhëzues janë përfshirë praktikat më të mira të institucioneve homologe dhe përvoja e deritanishme me dosjet për studiuesit, kërkuesit shkencorë dhe mediat kombëtare e të huaja.

Udhëzuesi është konceptuar për të ndihmuar dhe përmirësuar aksesin në arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe ka në fokus dy grupe specifike: përfaqësuesit e medias, ku përfshihen gazetarët e të gjitha formateve të publikimit (media e shkruar, media elektronike, dokumentuese, etj.), dhe anëtarët e botës akademike, ku përfshihen studiuesit shkencorë, vendas e të huaj, të të gjitha niveleve dhe të fushave të studimit.

Po ashtu, trajtimi i të dhënave personale, njoftimi i familjarëve kur është e mundur dhe mbledhja/dokumentimi i dëshmive të personit, familjes, trashëgimtarëve, krahas dosjes së Sigurimit, që të ruhen bashkërisht në arkivat e AIDSSH.

Me qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave standarde që duhet të ndiqen për trajtimin e kërkesave për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit, të paraqitura pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe në funksion të dhënies së informacionit e të

njoftimeve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është hartuar dhe miratuar Udhëzuesi "Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit".

5. ***Të krijojë infrastrukturën e nevojshme për shërbim sa më të shpejtë për të gjitha grupet e interesit që i drejtohen AIDSSH-së, duke u vendosur atyre në dispozicion dokumentet arkivore të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.***

Nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit janë realizuar 33% e kërkesave te institucionit për mjete te nevojshme pune ose pajisje zyre, si dhe 25 % si kalim kapitali nga institucionet e tjera buxhetore. Në vlerën 42 % të nevojave të institucionit për materialet e përmendura më sipër, donatorë të ndryshëm kanë financuar për infrastrukturën e deritanishme. Kjo përbën 32% të nevojave për mjete kompjuterike. Si rrjedhojë, mbeten pa plotësuar 68 % e kërkesave të institucionit, si pasojë e mungesës së fondeve financiare.

Sipas projektit përkatës të financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), "*Rikonstruksioni i godinës së Autoritetit dhe shërbime TIK për krijimin e një arkivi të integruar dhe modern*", janë kryer procedurat e prokurimit në lidhje me rikonstruksionin e godinës se re dhe supervizimin e kryerjes së punimeve ndërtimore.
Me përfundimin e rikonstruksionit të godinës, sipas projektit përkatës, studiuesit dhe qytetarët do të kenë mundësi t'i konsultojnë dokumentet arkivore në kushte optimale.
Sa i takon infrastrukturës, me zgjerimin e stafit, DMSHEQ ka rritur sasinë e materialeve të vëna në dispozicion studiuesve dhe mediave. Nga ana tjetër, rritja e stafit ka sjellë mungesën e kushteve të përshtatshme të punës për studiuesit dhe mediat, me mungesën e hapësirës së leximit dhe konsultimit me materialet, për të cilën janë bërë përshtatje të rastit.
Komunikimi online me studiuesit dhe mediat, mbi ngjarje historike, personalitete të kujtesës dhe hulumtime përkatëse është zgjeruar kryesisht gjatë pandemisë, ku është rritur ndjeshëm vizibiliteti i dokumenteve të AIDSSH, kontakti me të interesuarit dhe pasqyrimi mediatik, me ndërveprimin e përditshëm edhe të rrjeteve sociale të AIDSSH

Për rritjen e cilësisë së shërbimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, në funksion të veprimtarisë informuese për subjektet individuale, hulumtuese, të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, me plotësimin jotërësor të strukturë/organikës janë arritur ndryshime, si në kohën dhe cilësinë e shërbimit.
Me miratimin e "Rregullores së publikimeve të veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj", në faqen zyrtare dhe përmes buletinit, përcaktimi i procedurave organizative dhe teknike, si dhe

marrja e masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë së tyre, (proces i cili është konsultuar edhe me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale), veprimtaria është bërë më transparente dhe sasia e informacionit orientues është lehtësuar.

Gjithashtu, shkëmbimi i eksperiencave me institucione homologe të vendeve ish-komuniste, si një mënyrë efikase për t'u njohur dhe përfituar nga përvoja e tyre në përmbushjen e misionit të Autoritetit, ka kontribuar në këtë drejtim.

Në kuadër të zbatimit me përpikëri të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, përsa i takon mbledhjes, administrimit, përpunimit, përdorimit dhe informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, AIDSSH është udhëhequr nga parimet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Me gjithë vështirësitë e krijuara nga mungesa e mjediseve të punës dhe situatës së pandemisë, është krijuar infrastruktura e nevojshme, e cila ka vijuar të ofrojë shërbimin përkatës për të gjitha grupet e interesit që i drejtohen Autoritetit, duke u vënë në dispozicion, sipas objektit - kërkesës, dokumentet arkivore të krijuara nga ish- Sigurimi i Shtetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

6. ***Të rishikojë aktet nënligjore dhe nëse është e nevojshme, të adresojë propozimet përkatëse në Këshillin e Ministrave për të ofruar pa pagesë shërbimin me dokumentacion për ish-të përndjekurit politikë.***

Nëpërmjet rishikimit të akteve nënligjore është bërë i mundur ofrimi pa pagesë i shërbimit nga ana e institucionit, me dokumentacion për ish-të përndjekurit politikë, sipas kërkesave të paraqitura nga ana e tyre, në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale (Marrëveshje Autoriteti-Instituti i të Përndjekurve Politikë), në referencë të VKM-së nr. 93, datë 27.02.2019, "Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti".

7. ***Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet qeveritare për përfundimin e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën dhe u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për të ruajtur dhe mbrojtur në mënyrë adeguate vendet që aktualisht janë identifikuar si varreza masive.***

Bazuar në ligjin organik nr. 45/2015 i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*", si dhe në zbatim të ligjit nr. 9802, datë 13.9.2007 *"Për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare*

të OKB-së "Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë", Autoriteti ka zhvilluar takime koordinuese, edhe në zbatim të nenit 22/1 të ligjit "Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve" dhe urdhrit nr.150, datë 11.11.2019 të Kryeministrit "Për ngritjen e Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin dhe zbatimin e masave për kërkimin, identifikimin dhe kthimin në atdhe të eshtrave të shtetasit italian Giuseppe Terrusi", me:

Institutin e Arkeologjisë pranë ASA, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Ministrinë e Brendshme, ICMP, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit, Avokatin e Popullit, bashki dhe përfaqësues rajonalë të pushtetit dhe grupeve të interesit, takime ku është diskutuar mbi funksionet dhe protokollet përkatëse për kërkimin, identifikimin, gërmimin dhe zhvarrimin e të zhdukurve në diktaturë, me asistencën e ekspertëve të fushës dhe përdorimin e pajisjeve të duhura.

Përcaktimi i rolit të secilit prej aktorëve në proces, mbështetja institucionale dhe mbikëqyrja e të gjitha fazave, nga raportimi, identifikimi deri në verifikimin e viktimës përmes mostrës së ADN-së, janë hapi i radhës, para fillimit të procesit të gërmimeve.

Kontributi i Autoritetit dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime, do të vijojë me hartimin e rregullave të bashkëpunimit në marrëveshje dy apo shumëpalëshe, të lidhura për këtë qëllim me institucionet e sipërpërmendura.

Po ashtu, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 831/11, datë 10.08.2020, të AIDSSH dhe ICMP për projektin "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit të komunizëm", dy persona i janë bashkuar ekipit të AIDSSH, për të kontribuar për Udhëzuesin për familjarët e të zhdukurve, mbledhjen e dëshmive, kontaktet ndërinstitucionale, punën me arkivat me materialet e nevojshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror.

Instituti Polak i Kujtesës, IPN, institucion homolog, ka ofruar ekspertizë dhe AIDSSH po mban kontakte të rregullta për trajnime online, sa i takon çështjes së të zhdukurve në diktaturë.

8. *Të rrisë cilësinë e shërbimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, si dhe edukimit qytetar, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit.*

Kërkesat në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, si dhe edukimit qytetar, vijojnë të kenë interes të shtuar dhe zakonisht, janë kërkesa që kërkojnë punë voluminoze, jo vetëm në sasi dokumentesh, por në aspekte

historike. Me qëllim përmirësimin e shërbimit të kësaj kategorie kërkesash, brenda kapaciteteve që disponohen, është punuar paralelisht në disa drejtime, siç janë, përmirësimi i kërkimit arkivor, përgatitja për shqyrtim dhe deklasifikimi i dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror", digjitalizimi me cilësi i dokumenteve.

Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit janë shërbyer në funksion të veprimtarisë hulumtuese, kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit nga stafi i zgjeruar i DMSHEQ, i trajnuar gjatë kësaj kohe dhe i njohur me metodologjinë e punës, i cili i asiston studiuesit në të gjitha fazat e kërkesës, nga plotësimi, fazat e ndërmjetme të gjetjeve arkivore të kërkesave shumëfishe, konsultimi me materialet dhe vënia në dispozicion, me nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit.
Aplikimi për dosje studimore ose për interes mediatik mund të bëhet fizikisht, me asistencën e DMSHEQ, dhe online, sipas udhëzimeve përkatëse në faqen zyrtare të AIDSSH. Edhe në këtë rast, tërheqja e dublikatës së dokumentit dhe nënshkrimi i dokumentacionit shoqërues vijon të bëhet fizikisht nga kërkuesi i informacionit, ose me prokurë të posaçme.
Dorëzimi i materialeve në mënyra alternative të sigurta, studiuesve apo mediave aplikuese brenda dhe jashtë vendit, mbetet synim i ardhshëm i përmirësimit të shërbimeve, shkurtimit të kohës dhe rritjes së cilësisë.
Në vijim, *Udhëzuesi për studiuesit dhe mediat* orienton për të gjithë, hapat që duhen ndjekur, nga aplikimi deri në tërheqjen e materialeve, publikimin e tyre dhe përgjegjësinë për të dhënat që i transmetohen publikut të interesuar.
Në zbatim të planit vjetor janë organizuar hulumtime dhe është punuar për tekste informuese në kuadër të "Mendimit politik të së majtës shqiptare", Dialogut të Tiranës, Dialogut të Korçës dhe Maliqit, me komunitetin e Wikipedias shqip, etj., duke vënë në dispozicion dhe trajtuar me prioritet dokumentacionin përkatës.
Në kuadër të edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor, AIDSSH ka zhvilluar një sërë aktivitetesh:

1. Shkëmbim përvoje për zbardhjen e së shkuarës dhe rikthimin e dinjitetit viktimave të totalitarizmit, nëpërmjet IPN, Instituti Kombëtar Polak të Kujtesës;
2. Takim me kryetaren e Bashkisë Kurbin, znj. Majlinda Cara për Dialogun e ardhshëm lokal në zonë;
3. Shfaqje e dokumentarit "Persekutimi i "kulakëve" në diktaturë, Shaban Plaka"; bashkëpunim me komunitetin, familjarët dhe gazetaren Luljeta Progni
4. Aktivitet përkujtimor në kampin e Tepelenës, në ditën Europiane në Përkujtim të Viktimave të Totalitarizmit.
5. Tryeza e rrumbullakët "95 vjet Martin Camaj – Vepra dhe përndjekja", botimi është në proces.
6. AIDSSH dhe Fondacioni Friedrich Ebert në Tiranë finalizuan me dy botime, (version i gjatë studimor dhe i përmbledhur divulgativ), projektin mbi "Mendimin politik të së majtës,

profile biografike", i cili po përkthehet edhe në anglisht. 4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare 10 profileve të përzgjedhura, Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi, Petro Marko, Xhavit Qesja, Isuf Keçi, Zef Mala, duke riskicuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Po ashtu, vijon puna përgatitore për botimet mbi dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, të konferencave shkencore dhe tryezave të rrumbullakëta të AIDSSH-së, që e vënë theksin në ngjarje të rëndësishme për historinë e vendit 1944-1991.

Botimet dhe ribotimet janë produkt i marrëveshjes kuadër të realizuar për botime cilësore dhe të unifikuara të AIDSSH.

9. *Të analizojë nevojën për ndryshime të kuadrit ligjor, të cilat ndikojnë në përmbushjen me sukses të misionit të AIDSSH-së dhe krijojnë mundësinë për një produkt sa më cilësor në veprimtarinë e përditshme të institucionit.*

Nevoja për disa ndryshime dhe shtesa ligjore prioritare, të cilat në tërësi rregullojnë veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit te Shtetit, në zbatim të detyrave të ngarkuara nga ligji dhe në veçanti, ndryshime që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e afateve për verifikimin e figurave të zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë apo edhe të të zgjedhurve, motivuan Autoritetin për t'i adresuar Kuvendit amendimet e duhura ligjore në këndvështrimin juridik të tij.

Kryesisht, me ndryshimet e propozuara në dispozita të veçanta të ligjit 45/2015, u synua të arrihet:

-shmangia e problematikave të krijuara midis Autoritetit dhe institucioneve të tjera që administrojnë këto dokumente, gjatë procesit të dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra në këtë drejtim;

-eliminimi i vështirësive në vërtetimin e faktit të bashkëpunimit, për arsye se një pjesë e mirë e dokumentacionit për këtë kategori është asgjësuar, kategoritë e bashkëpunëtorëve janë me tipologji të ndryshme, ku për kategori si "strehues" ose "rezident" nuk ishte detyrim përdorimi i dokumentacionit shkresor;

-shmangie e pengesës për të informuar institucionet kërkuese të sistemit gjyqësor apo të vetingut në polici, lidhur me kriterin (anëtar) i cili nuk përcaktohet në ligjin nr. 45/2015,

-qartësimi i fatit të të vdekurve apo të të zhdukurve për të asistuar te të afërmit e personave të zhdukur, të cilët kërkojnë dokumente pranë AIDSSH, për t'u ardhur në ndihmë për të qartësuar fatin e familjarëve të tyre, nëpërmjet definicionit "persona të zhdukur", apo nëpërmjet dispozitave specifike

mbi rolin bashkëpunues të Autoritetit në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit;
-unifikimi i zbatimit konkret të ligjeve të vetingut (vetingu në gjyqësor dhe vetingu në polici) me ligjin 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë",
-nxjerrja e vendimeve që përmbajnë të dhëna të sakta dhe precize, duke minimizuar gabimet dhe korrigjimet e vendimeve të Autoritetit;
-informimi në shkallë të gjerë, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve, botimeve dhe në veçanti, pjesëmarrjes në media dhe rrjetet sociale, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ato luajnë në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik, siç është kërkuar në vijueshmëri në Kuvend, përmes rezolutave përkatëse;
Falë hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, kërkesat e paraqitura nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, janë trajtuar me përparësi, duke prevaluar kërkesat e cilësuara të rëndësishme dhe sensitive, në interes të opinionit publik (kërkesat nga KLP, KJGJ, për anëtarë të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit, Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit). Këto kërkesa kryesisht kanë qenë me afat të kufizuar kohor, në varësi të shqyrtimit të tyre në institucionin përkatës.
Gjithashtu, qartësimi i terminologjisë ligjore në përkufizime të termit "bashkëpunëtor", "anëtar i ish-Sigurimit të Shtetit", por edhe ndryshimet përkatëse në nenin 2, "Fusha e veprimit të ligjit", si edhe në nenin 29, pika 4, në funksion të dhënies së informacionit të saktë për subjektet kërkuese, ka kontribuar në minimizim të korrigjimit të informacioneve që rezultojnë të pasakta, pas konstatimit nga vetë Autoriteti apo personat e interesuar.

Sa më sipër, për periudhën objekt raportimi të detyrave të lëna nga rezoluta, ka pasur produkt cilësor në veprimtarinë e institucionit dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ky ligj, kryesisht në verifikimin e pastërtisë së figurave të zyrtarëve para emërimit apo ngritjes në detyrë.

05. VEPRIMTARIA E AIDSSH-SË PËR VITIN 2020

5.1 Aktiviteti i institucionit

Bazuar në Planin Strategjik 2017-2020, me vendimin nr. 46, datë 22.06.2017, Autoriteti ka miratuar "Planin vjetor të punës për vitin 2020 të Autoritetit". Mbi bazën e këtij dokumenti është mbështetur e gjithë veprimtaria institucionale e AIDSSH-së për vitin 2020, e cila, në terma të përgjithshëm dhe duke konsideruar kushtet në të cilën është ushtruar, pa dyshim mund të vlerësohet si e suksesshme.

5.1.1 Arkivi

Autoriteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe detyrave funksionale, për sa i takon fushës së arkivit mbështetet në dispozitat e ligjit nr. 45, datë 30.04.2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, Rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", e ndryshuar, akte rregullatore të brendshme që normojnë punën e Autoritetit, ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar; ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat"; Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë shërbimin civil, mbrojtjen e të dhënave personale, etj.

Bazuar në planin e punës për vitin 2020, veprimtaria në këtë fushë ka qenë e fokusuar në disa drejtime kryesore, si: Vijimi i procesit

Bazuar në Planin Strategjik 2017-2020, me vendimin nr. 46, datë 22.06.2017, Autoriteti ka miratuar "Planin vjetor të punës për vitin 2020 të Autoritetit". Mbi bazën e këtij dokumenti është mbështetur e gjithë veprimtaria institucionale e AIDSSH-së për vitin 2020, e cila, në terma të përgjithshëm dhe duke konsideruar kushtet në të cilën është ushtruar, pa dyshim mund të vlerësohet si e suksesshme.

të marrjes në dorëzim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit sipas parashikimeve të ligjit 45/2015, me qëllim përfundimin brenda vitit; transferimi fizik i dokumenteve arkivore, nga godinat e arkivit pranë SHISH dhe IPQP, në godinën e re të AIDSSH-së; kërkimi dhe vënia në dispozicion e dokumenteve arkivore sipas kërkesave të legjitimuara nga Autoriteti (kërkesa institucionale, individuale, të kërkuesve shkencorë dhe mediave); shqyrtimi i dokumenteve të klasifikuara dhe përgatitja e praktikave përkatëse, në funksion të organizimit të mbledhjeve të KDZH-së; pasurimi i vazhdueshëm i arkivit digjital të AIDSSH-së, nëpërmjet digjitalizimit të dokumenteve dhe mikrofilmave; përmirësimi i mjeteve ekzistuese të kërkimit dhe krijimi i mjeteve të reja; zbatimi i procedurave standarde të sigurisë dhe ruajtjes së dokumenteve arkivore, sipas legjislacionit në fuqi; përmirësimi dhe standardizimi i praktikave të zbardhjes së bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit (1944-1991); rritja e nivelit të aftësive profesionale të punonjësve të drejtorisë.

5.1.1.1 Marrja në dorëzim e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit sipas ligjit 45/2015, i ndryshuar

Bazuar në nenin 10 të ligjit 45/2015, ndër të tjera, Autoriteti ka përgjegjësi: grumbullimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj; bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të këtij ligji. Në këtë kuadër, në vitin 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione, të cilat kishin nën administrim dokumente arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, konkretisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Shërbimi Informativ i Shtetit ka përfunduar brenda afateve dorëzimin e të gjithë dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas VKM nr. 98/2017. Ministria e Brendshme, Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Zbatimi i marrëveshjes së përbashkët me Ministrinë e Brendshme është bllokuar që prej muajit maj 2019. Ky institucion, edhe pse ligji 45/2015 e ka përcaktuar qartë detyrimin e institucioneve arkivore në Republikën e Shqipërisë në marrëdhënie me AIDSSH, vijon të refuzojë dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që ruhen si pjesë e fondeve arkivore të administruara nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme. Drejtoria e Arkivit, si struktura përgjegjëse në nivel teknik për realizimin e procesit të marrjes në dorëzim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet dorëzuese, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga Autoriteti, ka informuar Autoritetin për situatën e krijuar në lidhje me zbatimin e marrëveshjes me Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Brendshme. Për zgjidhjen e situatës së krijuar për sa më sipër, gjatë vitit 2020 janë realizuar disa takime ndërmjet

përfaqësuesve të niveleve të larta dhe nivelit teknik të të dy insitucioneve.

5.1.1.2 Transferimi fizik i dokumenteve arkivore

Në Planin Strategjik të AIDSSH 2017-2020, Autoriteti ka të përcaktuar si një nga objektivat kryesore, krijimin e një arkivi të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura, të përftuara nga veprimtaria e ish-Sigurimit, ose të lidhura me të. Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, për vitin 2020, Autoriteti ka planifikuar transferimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat janë marrë në dorëzim nga SHISH dhe ASMB, në godinën e re të vënë në dispozicion nga Qeveria. Transferimi fizik i dokumenteve arkivore është proces shumë i rëndësishëm dhe kërkon që paraprakisht, të sigurohen kushtet e ruajtjes fizike, si dhe të hartohen e miratohen procedurat përkatëse.

Përsa i takon sigurimit të kushteve të ruajtjes fizike të dokumenteve arkivore, sikurse është raportuar edhe më parë, nga ana e Autoritetit është arritur të sigurohen fondet për rikonstruksionin dhe përshtatjen e godinës së Autoritetit, blerjen dhe montimin e rafteve për arkivin, si dhe sigurimin e infrastrukturës TIK. Përpara transferimit fizik të dokumenteve arkivore, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar procedurat e prokurimit për blerjen dhe montimin e rafteve të arkivit, procedurë prokurimi e finalizuar në shtator 2020, me marrjen në dorëzim të rafteve.

Përsa i takon hartimit dhe procedurave përkatëse të transferimit fizik të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, pas përfundimit të kësaj procedure dhe marrjes në dorëzim të rafteve të arkivit, Drejtoria e Arkivit, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse të institucionit, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorinë e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik, Sektorin Juridik, ka punuar dhe ka përgatitur dokumentet përkatëse për transferimin fizik të dokumenteve nga vendruajtjet që ndodhen pranë SHISH dhe ASMB, të cilat më pas janë miratuar nga Autoriteti.

Për transferimin fizik të dokumenteve që ruheshin në godinën e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, pranë IPQP, për në godinën e re të AIDSSH, brenda territorit të pronës nr.12, me emërtim "Komanda e doktrinës dhe stërvitjes", Ministria e Mbrojtjes, është hartuar dhe miratuar nga Autoriteti, vendimi nr. 671, datë 3.12.2020 «Për ngritjen e grupit të punës që do të ndjekë dhe realizojë procedurat e transferimit fizik në mënyrë të plotë të të gjitha dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat janë marrë në dorëzim nga AIDSSH, dhe që aktualisht ruhen në godinën e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, e cila ndodhet pranë IPQP".

Pas miratimit të vendimit, është ngritur grupi i punës për ndjekjen e procedurave të transferimit fizik në mënyrë të plotë të të gjitha dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat janë marrë në dorëzim nga AIDSSH dhe që aktualisht ruhen në godinën e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme.

Procesi i transferimit të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit nga godina e arkivit pranë IPQP te godina e re e Autoritetit, u

realizua në datat 21-22 dhjetor 2020, me angazhimin e punonjësve të AIDSSH të pajisur me certifikata sigurie nga DSIK, që plotësojnë kriteret përkatëse ligjore për këtë qëllim.

Për transferimin fizik të dokumenteve nga arkivi i AIDSSH pranë SHISH, në godinën e re të AIDSSH, e cila ndodhet brenda territorit të pronës nr.12, me emërtim "Komanda e doktrinës dhe stërvitjes", Ministria e Mbrojtjes, nga Autoriteti janë hartuar dhe miratuar dokumentet:

1. Vendimi "Mbi transferimin fizik të dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që janë marrë në dorëzim nga AIDSSH, dhe që aktualisht ruhen në ambientet e SHISH".
2. Aneksi I "Mbi transferimin fizik të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit që ruhen në arkivin që ndodhet në ambientet e SHISH", pjesë integrale e draftvendimit të mësipërm.
3. Aneksi II "Rregullat e punës dhe sigurisë në godinën e re", pjesë integrale e draftvendimit të mësipërm.

Për realizimin e kësaj procedure janë kryer komunikime shkresore me strukturat përkatëse shtetërore për sa i takon sigurimit të automjeteve dhe personelit që do të angazhohet, procedurë që do të realizohet gjatë vitit 2021.

5.1.1.3 Kërkimi dhe vënia në dispozicion e dokumenteve arkivore sipas kërkesave të legjitimuara

Gjatë periudhës së raportimit, nga janari deri në dhjetor 2020, nga arkivi janë trajtuar **554** kërkesa të reja ndër të cilat, **80** kërkesa institucionale në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale

dhe profesionale të 106 kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra, dhe 47 kërkesa për verifikime për propozime për dhënie dekoratash, tituj nderi, **270** kërkesa individuale të paraqitura nga të prekurit ose në cilësinë e të afërmit të të prekurit, **117** kërkesa për pajisje me vërtetim të periudhës së internimit/dënimit, **12** kërkesa për zbardhjen e bashkëpunëtorëve dhe **75** kërkesa studimore.

Edhe gjatë këtij viti, dokumentet arkivore kanë qenë të vendosura fizikisht në dy mjedise të ndryshme, konkretisht në godinën e Arkivit të Sistemit të MB, e cila ndodhet pranë IPQP dhe SHISH. Në këto kushte, proceset e kërkimit, identifikimit, transportimit, ndjekjes së procedurave që kanë të bëjnë me përgatitjen e dokumenteve për shqyrtim nga KDZH dhe vënies në dispozicion të dokumenteve arkivore për kërkesat e mësipërme për informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, janë punuar paralelisht dhe në koordinim ndërmjet stafit të sektorit të ruajtjes së fondeve dhe sektorit të përpunimit.

Sektorët e Drejtorisë së Arkivit në fillim të vitit kanë punuar me kërkimin, identifikimin dhe kthimin e përgjigjeve të kërkesave të vitit 2019, konkretisht 23 përgjigje shkresore, nga të cilat 17 përgjigje, me të dhëna dhe 6 janë përgjigje negative. Ndërsa përsa i takon 554 kërkesave të reja të ardhura gjatë vitit 2020, nga Drejtoria e Arkivit është kryer kërkimi arkivor, janë digjitalizuar dhe janë përgatitur përgjigjet shkresore për **517** kërkesa, sikurse janë paraqitur në grafikun më poshtë:



Kërkesat për zbardhjen e bashkëpunëtorëve janë kategoria e kërkesave më të vështira që trajton Drejtoria e Arkivit në bashkëpunim me Drejtorinë e Informacionit. Ky proces mjaft kompleks, sensitiv ka ecur ngadalë, edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore të paplotësuara në strukturë/organikën e institucionit, më së shumti për arsye të mungesës së dokumenteve, të mënyrës se si janë plotësuar në të shkuarën nga ish-strukturat përgjegjëse, numri i madh i bashkëpunëtorëve etj., por me hartimin e më pas miratimin me vendimin nr.538, datë 07.10.2020 të Udhëzuesit të posaçëm *"Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish – Sigurimit të Shtetit"*, procesi po ecën normalisht.

Me gjithë vështirësitë e mësipërme, gjatë vitit 2020 është realizuar kërkimi, identifikimi, deklasifikimi dhe përcjellja e 18 praktikave për zbardhjen e bashkëpunëtorëve.

5.1.1.4 Deklasifikimi i dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror"

Një tjetër proces pune shumë i rëndësishëm, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij është përgatitja e relacioneve për deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara, si dhe ndjekja e procedurës për njoftimin dhe zhvillimin e mbledhjeve të KDZH-së. Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar **27** mbledhje të KDZH-së dhe janë marrë **27** vendime, sipas së cilave janë deklasifikuar 52.867 fletë dokumente arkivore, sipas grafikut më poshtë.

Bibliografitë e dokumenteve të deklasifikuara i janë dërguar DSIK dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së.



5.1.1.5 Digjitalizimi i dokumenteve arkivore

Sektori i Digjitalizimit dhe i Fotokopjes është një nga tre sektorët e Drejtorisë së Arkivit të AIDSSH, që ka për detyrë të organizojë dhe drejtojë punën për procesin e digjitalizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në administrim të AIDSSH, si dhe përgjigjet për regjistrimin, organizimin, ruajtjen dhe administrimin e materialeve arkivore të digjitalizuara.

Gjatë periudhës së raportimit janë digjitalizuar 154 dosje fizike dhe 57 dosje të mikrofilmuara, me një total prej **120.478** fletë dokumente arkivore, sikurse janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Të gjithë dokumentet e digjitalizuara janë kopjuar në pajisjen e ruajtjes (server) dhe regjistrin përkatës elektronik.

Përveç digjitalizimit, sektori ka përgatitur dhe ka vënë në dispozicion CD-të me dokumentet e anonimizuara paraprakisht nga Drejtoria e Informacionit dhe Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Edukimit Qytetar. Pas kryerjes së procesit të anonimizimit nga drejtoritë përkatëse, janë kopjuar 331 CD, të cilët i janë përcjellë DI apo DMSHEQ kundrejt procedurave përkatëse.

5.1.1.6 Zbatimi i procedurave standarde të sigurisë dhe ruajtjes së dokumenteve arkivore

Gjatë kryerjes së detyrave funksionale, duke u mbështetur në ligjin nr. 45, datë 30.04.2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Rregulloren "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", e ndryshuar, aktet rregullatore të brendshme që normojnë punën e Autoritetit, ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar; ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, janë zbatuar me rigorozitet procedurat standarde të sigurisë dhe ruajtjes së dokumenteve arkivore.

5.1.1.7 Ekspozita dokumentare

Gjatë kësaj periudhe, nga Drejtoria e Arkivit janë përgatitur dhe paraqitur tre ekspozita dokumentare, si më poshtë:

1. Ekspozita dokumentare në kuadër të Ditëve të Kujtesës 2020**, "Çamëria në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit",** ku janë ekspozuar 20 dosje, me 4139 fletë.
2. Ekspozita dokumentare **"Emigracioni Politik**", ku janë ekspozuar 40 dosje, me 12671 fletë. Ekspozita u realizua në kuadër të konferencës shkencore me të njëjtin titull, organizuar nga AIDSSH dhe partnerët.
3. Ekspozita dokumentare në kuadër të aktivitetit **"95 vjet Martin Camaj - Vepra dhe Përndjekja".**

Për organizimin me sukses të ekspozitave të mësipërme janë studiuar, identifikuar, përgatitur dokumentacioni arkivor sipas temave përkatëse, në bashkëpunim me DMSHEQ, dhe janë kryer të gjitha procedurat e tërheqjes nga arkivi, propozimet për deklasifikim dhe paraqitja e tyre në ekspozitë.

5.1.2.Informacioni

Gjatë vitit 2020, edhe pse në kushte të vështira të shkaktuara nga pandemia Covid 19, duke punuar online dhe me raste, me orar të reduktuar, janë arritur rezultate në zbatim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, rregullore, urdhra dhe udhëzime.

Në vlerësim të kërkesave të paraqitura nga subjektet kërkuese (person i prekur, palë e tretë, i afërm i personit të vdekur/zhdukur, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit) janë zhvilluar procedura korrekte nga fillimi deri në përmbyllje të procedurës, duke parë ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e dokumentacionit të paraqitur në institucion, për ta paraqitur më pas në mbledhje të Autoritetit, kërkim të informacionit në Drejtorinë e Arkivit, përpunim i dokumentacionit, anonimizim, deri në procesin e vendimmarrjes së Autoritetit sipas objektit të kërkesës dhe dhënien e informacionit përkatës kërkuesit.

E shprehur në shifra, kërkesat individuale dhe institucionale janë trajtuar në **41 mbledhje** të Autoritetit, ku janë paraqitur për legjitimim **506 kërkesa të reja** (kërkesa individuale 282, kërkesa institucionale 106, kërkesa për qëllime rehabilitimi 117, kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë 1), për informim dhe vlerësim, për të cilat është kthyer përgjigje për **1236 individë** e subjekte të trajtuara në procedurë standarde. Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga objekti, qëllimi dhe misioni i institucionit në zbatim të ligjit 45/2015, si dhe rregullores, urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse, është mbyllur me procedurë të rregullt, shoqëruar me vendimmarrjen përkatëse, verifikimi dhe informimi i individëve dhe subjekteve sipas kërkesave, si në grafikun më poshtë:



Gjatë vitit 2020, në gjuhën e shifrave rezulton se:

- Janë paraqitur për legjitimim **282 kërkesa individuale,**
- Janë mbyllur në total **509 kërkesa individuale,** nga të cilat:
  - **27 kërkesa të 2018**,
  - **292 kërkesa të 2019,**
  - **190 kërkesa të 2020**.



- Janë paraqitur 106 kërkesa institucionale, për verifikimin e 217 kandidatëve,
  - janë mbyllur procedurat e verifikimit për 214 kandidatë,
  - 11 kandidatë (individë) kanë rezultuar me probleme.



- Është paraqitur 1 kërkesë individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi;
- Janë paraqitur 117 kërkesa individuale dhe institucionale ISSH-së për efekt pensionesh, për 122 shtetas;
- Janë përgatitur 633 vendime (485 individuale + 148 institucionale).



I organizuar në katër mujorë, më poshtë paraqitet i detajuar aktiviteti i Drejtorisë së Informacionit, me të dhënat si vijon:

i) Trajtimi i kërkesave individuale për informim



Për periudhën 4 mujore, 1 janar – 30 prill 2020, rezulton se në total, në 12 mbledhje janë paraqitur për:

- legjitimim, 63 kërkesa të reja;
- mbyllje procedure, 182 kërkesa nga të cilat:
  - me dokumentacion arkivor janë 108 kërkesa,
  - pa dokumentacion arkivor janë 72 kërkesa.



Për periudhën 4 mujore, 1 Maj – 30 Gusht 2020, rezulton se në total, në 10 mbledhje janë paraqitur për**:**

- legjitimim, 98 kërkesa të reja;
- mbyllje procedure, 117 kërkesa, nga të cilat:
  - me dokumentacion arkivor janë 77 kërkesa,
  - pa dokumentacion arkivor janë 40 kërkesa.

Për periudhën 4 mujore, 1 shtator – 31 dhjetor 2020, rezulton se në total, në 19 mbledhje janë paraqitur për**:**

- legjitimim, 119 kërkesa të reja;
- mbyllje procedure, 189 kërkesa, nga të cilat:
  - me dokumentacion arkivor janë 125 kërkesa,
  - pa dokumentacion arkivor janë 58 kërkesa.



Në total, në përmbledhje të shifrave për periudhën 12 mujore, 1 janar – 31 Dhjetor 2020 janë paraqitur për:

- legjitimim, 280 kërkesa të reja;
- mbyllje procedure, 509 kërkesa, për të cilat:
  - janë përgatitur 485 vendime.
  - me dokumentacion arkivor janë 327 kërkesa (ku 15 janë zbardhje b.p),
  - pa dokumentacion arkivor janë 170 kërkesa.

- Janë përpunuar më shumë se 130.000 faqe dokumentacion arkivor.
- Janë anonimizuar mbi 43.000 faqe dokumentacion arkivor i digjitalizuar.

Në ushtrim të detyrës është punuar për mbrojtjen e të dhënave gjatë dhënies së informacionit. Në mënyrë të veçantë të të dhënave që përbëjnë të dhëna personale, në përputhje me ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar) dhe ligjin nr.119/2014 "Për të Drejtën për Informim". Autoriteti krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi dhe dhënies së informacionit, është përpjekur ta bëjë informacionin lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.







ii) Trajtimi i kërkesave për informim nga institucionet

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat e hasura gjatë vitit 2020, Autoriteti ka kryer brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t´u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t'u zgjedhur në/nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, institucioni i Presidentit të Republikës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, anëtarë të Gjykatës

Kushtetuese, anëtarë të Gjykatës së Lartë, SPAK, BKH, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Garda e Republikës dhe institucionet e tjera të paraqitura.

Më 29 korrik 2020 u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ligji *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"* i cili hyri në fuqi më *11.09.2020, pas botimit në Fletoren Zyrtare.*
Në total, për periudhën janar - dhjetor 2020 nga Autoriteti janë marrë 148 vendime dhe janë verifikuar 214 kandidatë, nga të cilët 203 kanë kaluar filtrin sepse janë të pastër, ndërsa për 11 kandidatë rezultojnë dokumente, pra figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si b.p. ose punonjës të strukturave të ish-Sigurimit, ose anëtarë trupi gjykues në procese politike që lidhen me fushën e veprimit të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Në total, në përmbledhje të shifrave vjetore rezulton se:

- janë paraqitur për legjitimim 106 kërkesa të reja, për 217 kandidatë;
- janë mbyllur procedurat e verifikimit për 214 kandidatë;
- janë marrë 148 vendime;
- 11 kandidatë (individë) kanë rezultuar me probleme.

Krahasuar me vitin 2019, ku rezultonte se:

- Janë paraqitur për legjitimim 135 kërkesa të reja, për verifikimin e 286 kandidatëve, përpara emërimit, ngritjes në detyrë apo dekorim;
- Janë mbyllur procedurat e verifikimit për 342 kandidatë, nga të cilët 16 kandidatë figuruan me dokumente;
- Janë marrë 190 vendime nga Autoriteti.

Për vitin 2020 ka rënie të lehtë, por të justifikuar në numrin e kërkesave të paraqitura nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, në numrin e kandidatëve të verifikuar dhe në numrin e vendimeve të dala drejtuar institucioneve kushtetuese, kjo për arsye të ndërprerjes së procedurave të verifikimit për





kandidatët që emërohen e ngrihen në detyrë për një periudhë disamujore, deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore.

iii) Trajtimi i kërkesave individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi

Ka vijuar puna me pajisjen me dokumentacion për efekte pensioni për ish-të përndjekurit politikë, në lidhje me faktin e qenies në kampet e vuajtjes së dënimit dhe faktin e qenies në internim për motive politike të personave.





Gjatë 2020 janë marrë në shqyrtim dhe trajtuar 117 kërkesa për 122 shtetas, kërkesa për efekt pensioni, duke bërë verifikimin e faktit të qenies në kampet e vuajtjes së dënimit (minierë), si dhe verifikimi i faktit të qenies në internim të personave.
Nga kërkesat e paraqitura janë përmbyllur dhe kthyer përgjigje për 99 praktika, ndërsa 23 të tjera janë në proces verifikimi.

Në lidhje me këto kërkesa, për 65 prej tyre është kthyer përgjigje se ka pasur dokumentacion dhe për 34 ka rezultuar se nuk është gjetur dokumentacion.

Gjatë vitit 2020, është paraqitur vetëm 1 kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, e cila është trajtuar dhe kthyer përgjigje.
Në kuadër të së Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në zbatim të parashikimeve të ligjit 119/2014, pranë AIDSSH-së janë paraqitur gjithsej 6 kërkesa për periudhën janar-dhjetor 2020, përgjigjet e të cilave janë dhënë brenda afateve ligjore.
Në asnjë rast, nga Zyra e Komisionerit nuk është kërkuar, as ka pasur kontestim për përmbushjen e kësaj detyre dhe veprimtarie, në ndryshim me vitin e kaluar, ku komisioneri për informim ka qenë pjesë e një hetimi administrativ, për të cilin është marrë vendim duke e gjetur të drejtë qëndrimin e AIDSSH.

iv) Menaxhimi i rriskut

Menaxhimi i rriskut si çelës në suksesin e institucionit, duke nisur nga identifikimi dhe menaxhimi i tij është komponent i rëndësishëm në punën e AIDSSH, pasi ka të bëjë me vënien në diskutim të realizimit të detyrave dhe standardeve të synuara. Tashmë rrisku është i identifikuar, por me gjithë punën e kryer dhe përmirësimet e ndjeshme, përsëri mbetet prezent, për arsye e shkaqe të plotësimit të strukturë/organikës, kushteve të punës, të cilat çojnë në mospërmbushje në kohë të detyrave, të përmbylljes së praktikave që, në zbatim të ligjit 45/2015, kanë procedurën e përpunimit dhe anonimizimit, me qëllim ruajtjen e të dhënave personale, të karakterit konfidencial për çështje të sigurisë kombëtare, mbrojtjen e të prekurve apo palëve të treta, etj. Në këtë kuadër, hasen probleme në ofrimin e shërbimeve në interes të publikut, përmbushjen e objektivave dhe arritjen e suksesit.

5.1.3 Hulumtimi Shkencor dhe Edukimi Qytetar

Në mbështetje të nenit 36, 37, 38 të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", nenit 42 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Autoriteti është përgjegjës për:

- Informimin e studiuesve dhe mediave të interesuara për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e dublikatave të tyre te kërkuesi, brenda afateve kohore të përcaktuara në akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit organik 45/2015;
- Mbështetjen e veprimtarisë hulumtuese, të kërkimit shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve.
- Në funksion të edukimit qytetar, me qëllim informimin e qytetarëve për dokumentet dhe veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit në tërësi, dhe me fokus brezat e rinj në veçanti, Autoriteti zhvillon veprimtari që ndihmojnë në formësimin e vetëdijes civile për rindërtimin e narrativës të së shkuarës komuniste, të mbështetur mbi kërkimin shkencor, brenda fushës së veprimit të këtij ligji.

Me shtimin dhe plotësimin e organikës në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020 për Drejtorinë e Mbështetjes Shkencore dhe Eukimit Qytetar (DMSHEQ) është shkurtuar koha e trajtimit cilësor të kërkesave për qëllime studimore dhe mediatike, anonimizimi në kohë i dokumenteve të kërkuara, përmbledhja e shkruar e të dhënave historike të dosjeve të trajtuara dhe shfrytëzimi i tyre për publikimet në faqen zyrtare rrjetet sociale të Autoritetit. Po ashtu, puna me vendimet dhe buletinët e

përdymuajshëm. Natyrisht, stafi i sapoemëruar i DMSHEQ ka nevojë të trajnohet dhe të krijojë përvojë në fushën e vet të veprimit, për të rritur cilësinë e synuar të shërbimeve nga Autoriteti.

5.1.3.1 Mbështetja shkencore

Në këtë fazë, mbështetja shkencore bazohet kryesisht në përpunimin e kërkesave individuale të studiuesve dhe medias për qëllime studimore dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor të kërkuar. Ky proces është kompleks sa u takon kërkesave studimore, kur për një kërkesë vihen në dispozicion nga 1 deri në 400 dosje, për rrjedhojë merr kohën e vet, që nga kërkimi në arkiv, identifikimi i dosjeve, digjitalizimi, anonimizimi, kontakti me familjarët dhe vënia në dispozicion studiuesve.

1. Trajtimi i kërkesave për qëllime studimore

1.1. Praktika të paraqitura gjatë vitit 2020

Gjatë vitit 2020, pranë Autoritetit janë paraqitur **114 kërkesa** studimore/mediatike, të cilat janë në faza të ndryshme të trajtimit të tyre. Nga këto kërkesa, të cilat e kanë kaluar procesin e legjitimimit, **48 praktika janë të mbyllura.** Materialet janë trajtuar dhe dokumentacioni i gjetur nga Drejtoria e Arkivit është përpunuar dhe është vënë në dispozicion të studiuesve/ medias kërkuese të informacionit. Për dosjet e trajtuara në 2020 është mbajtur përmbledhje, duke bërë evidentim të të dhënave përkatëse. Të gjitha kërkesat e tjera, **66**, janë trajtim e sipër. Ndër praktikat e trajtuara, në total 114:





120 kërkesa të mbyllura gjatë vitit 2020 nga DMSHEQ



- 89 janë paraqitur nga studiues dhe institucione kërkimore;
- 25 nga media dhe institucione mediatike;
- 98 kërkesa për informim janë bërë nga studiues vendas;
- 16 nga studiues dhe institucione të huaja;

Po ashtu, janë trajtuar dhe mbyllur rreth **37** kërkesa të mbartura nga viti 2019 dhe **35** kërkesa të vitit 2018, ndërsa janë në proces dhe janë trajtuar pjesërisht rreth 19 kërkesa shumëfishe, që duan kohë më të gjatë kërkimi në arkiv.

Gjatë trajtimit të secilës kërkesë, sektori

40 kërkesa të mbartura nga viti 2018



51 kërkesa të mbartura nga viti 2019



ka mbajtur komunikim me kërkuesit e dokumentacionit, duke u shpjeguar fazat nëpër të cilat kalon praktika, mbajtur të informuar dhe kërkuar informacione shtesë për verifikimin e të saktë të dokumentacionit për të cilin është aplikuar. Studiuesit janë konsultuar me dokumentacionin e gjetur nga Drejtoria e Arkivit, pas vendimeve të Autoritetit, dhe kanë firmosur deklarata të konfidencialitetit, të bashkënënshkruara nga DMSHEQ dhe një anëtar i Autoritetit.

1.2. Trajtimi i dokumenteve arkivore, anonimizimi, vënia në dispozicion

Qëllimi i Autoritetit për t'i siguruar të drejtën çdo qytetari, studiuesi, medie për të shqyrtuar informacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, duke mbrojtur privatësinë dhe identitetin e palëve të treta, po ashtu duke qenë transparentë, realizohet në zbatim të ligjit 45/2015, i ndryshuar.

Dokumentet arkivore, para se të vihen në dispozicion të kërkuesve shkencorë apo medias, kalojnë në procesin e anonimizimit, që bën të palexueshme të dhënat personale dhe sensitive. Gjatë vitit 2020 janë vënë në dispozicion 451 dosje, me rreth 68.396 faqe, ndër të cilat rreth 17.557 kanë kaluar në proces anonimizimi.



1.3. Mbledhje, shkresa, vendime në nivel statistikor

Në kuadër të raportimit të punës për vitin 2020, në vijim të dhënat statistikore:

- 114 kërkesa për informim për qëllime të kërkimit shkencor apo medias janë trajtuar në 69 mbledhje të Autoritetit dhe 104 shkresa dërguar Drejtorisë së Arkivit;
- Rreth 75 vendime janë marrë për vënie në dispozicion të dokumenteve të gjetura nga DA; janë hartuar e firmosur nga kërkuesit në prani të një punonjësi të Sekretariatit Teknik, po aq deklarata konfidencialiteti.
- Është përditësuar databaza e kërkesave të mbërritura pranë institucionit në koordinim midis drejtorive kur lind nevoja për bashkërendim të praktikave të punës (nëse dosja është kërkuar më herët, është digjitalizuar, është marrë miratimi i familjarit, etj), duke bërë rakordim periodik mujor për të gjitha kërkesat e trajtuara, për t'u ardhur në ndihmë studiuesve në kohë sa më të shkurtër.
- Mediat kanë rritur kërkesat pranë Autoritetit, të cilat variojnë, nga kërkesa për një person apo histori/ngjarje të caktuar, në kërkesa për shumë persona apo histori/ngjarje të caktuara, fakt që e bën natyrën e trajtimit të kërkesave studimore/mediatike më komplekse e të larmishme, shton përgjegjësinë dhe volumin e punës për sektorin e kërkesave studimore/mediatike.

1.4. Aktivitete të kryera për përmirësimin dhe përshpejtimin e procesit të punës në trajtimin e kërkesave studimore/mediatike dhe rritjen e efektivitetit e eficencës në punë, për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të kërkesave për informim

Mbledhja dhe administrimi i të dhënave ka vijuar në bazë të kërkesave të bëra pranë Autoritetit: praktika e kërkesës, të dhënat mbi personin/ngjarjen historike, dokumente të kërkuara, fazat e përpunimit të kërkesës, kontakti me studiuesin/median, njoftimi i familjarëve kur është e mundur, përmbledhja e dosjes së ngjarjes apo personazhit historik. Ndërkohë:

- Është hartuar Udhëzuesi për "Aksesin dhe përdorimin e arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues", i konceptuar për të ndihmuar dhe përmirësuar aksesin në arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Udhëzuesi ka në fokus dy grupe specifike: anëtarët e botës akademike, ku përfshihen studiuesit shkencorë, vendas dhe të huaj, të të gjitha niveleve dhe të fushave të studimit, si dhe përfaqësuesit e medias, ku përfshihen gazetarët e të gjitha formateve të publikimit (media e shkruar, media elektronike, dokumentuese, etj.). Në të janë përfshirë të gjithë hapat që duhen të ndiqen për aplikime të studiuesve shqiptarë dhe të huaj, po ashtu të mediave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe trajtimi i praktikave përkatëse. Për finalizimin e tij është shfrytëzuar ekspertiza e OSBE-së, e cila e ka mbështetur këtë proces që në zanafillë, praktikat e përditshme të punës së AIDSSH në marrëdhënie me studiues e media dhe përvoja më e mirë e institucioneve homologe ndërkombëtare në këtë fushë. Udhëzuesi për studiuesit dhe mediat u miratua në Autoritet më 24.09.2020, me vendimin nr. 491.
- Janë mbledhur dhe organizuar të dhënat mbi dokumentet e identifikuara dhe të digjitalizuara, përditësuar dhe përshtatur databaza e informacioneve për lehtësimin e kërkimit nga studiuesit; zgjeruar databaza përkatëse me të dhëna rreth dokumenteve të digjitalizuara, anonimizuara dhe përmbajtjes së dosjeve përkatëse, bërë evidentim.
- Është treguar kujdes në ndjekjen e parimit të transparencës dhe ruajtjes së privatësisë. Sipas ligjit, kur ka qenë e mundur, është kërkuar miratimi i familjarit para vënies së dosjes në dispozicion, sipas dispozitave të ligjit në fuqi 45/2015, ligjit për arkivat nr. 9154, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 48/2012, për mbrojtjen e privatësisë dhe dispozitave të tjera ligjore përkatëse, mbështetur në pikën 4 të Planit Strategjik, po ashtu në objektivin strategjik, 1.2 "*Vendosja e dosjeve në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e aksesit në informacionin në formë digjitale*".
- Përgjatë 2020, janë trajtuar dy raste praktikash të cilat paraqitën probleme lidhur me qëllimin e kërkimit dhe më pas publikimin

e materialit të tërhequr nga Autoriteti. Praktikat në fjalë zbuluan problematika të trajtimit të dosjeve të personaliteteve historike dhe u bënë shkas i vëmendjes së shtuar në trajtimin e informacionit në të gjitha fazat e procesit. Konkretisht:

- Kërkesat e paraqitura pranë Autoritetit për informim mbi dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit në ngarkim të dy shtetasve, persona historikë të kohës, Komiteti "Shqipëria e lirë", Blloku Indipendent dhe Komiteti i Prizrenit 1948 – 1960 dhe në ngarkim të komuniteteve fetare në Shqipëri. Sipas formularëve të plotësuar, kërkuesit u paraqitën në cilësinë e studiuesve dhe informimin e kërkuan për qëllime të kërkimit shkencor, jo publikimit. Secila prej kërkesave u trajtua në Autoritet dhe në lidhje me ta u ndërmorën veprime administrative.

➢ Në kushtet e krijuara nga Covid 19, puna në trajtimin e kërkesave studimore u fokusua, jo vetëm në përpunimin e dosjeve, por edhe në shkrimin e teksteve përkatëse përmbledhëse informuese mbi to, tekste të përgatitura për publikimet *online* në faqet e institucionit. Informacionet janë plotësuar sistematikisht për të gjitha dosjet e vëna në dispozicion.

5.1.3.2 EDUKIMI QYTETAR

1.Trajtimi i projekteve studimore dhe audiovizuale

Sektori në fjalë mbulon të gjithë veprimtarinë komplekse që ka të bëjë me komunikimin me publikun, publikimet në letër dhe *online*, (vendime, buletinë, raporte, botime të Autoritetit), organizimin e konferencave, tryezave, vizitave, etj., të Autoritetit, kontaktet me partnerët, homologët shqiptarë dhe ndërkombëtarë, projektet institucionale dhe në bashkëpunim, kontaktet dhe punën paraprake për marrëveshjet ndërinstitucionale, çështjen e të zhdukurve, takimet në terren, punën me dëshmitë, koordinimin me të tretët.

Kësisoj, është organizuar puna për:

a. Realizimin e aktiviteteve në kuadër të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar;
b. Tryezat e punës me institucionet bashkë-punuese;
c. Ekspozitat tematike;
d. Nënshkrimin dhe ndjekjen e marrë-veshjeve me partnerë;
e. Ndjekjen e projekteve të AIDSSH

me synim realizimin e objektivave informues. Nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike për ngjarje tronditëse mbi viktima të pafajshme të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike dhe të marra në mënyrë autentike nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit, si edhe bashkëpunimit me institucionet qeveritare për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën dhe u ekzekutuan gjatë komunizmit, është synuar:

– Informimi i qytetarëve, ndërgjegjësimi i shoqërisë në përgjithësi dhe e të rinjve në veçanti. Angazhimi i studiuesve dhe medias në studimin dhe trajtimin e dokumenteve, në administrim të AIDSSH,

me qëllim thellimin në faktet dhe të vërtetat e ish-Sigurimit të Shtetit dhe përndjekjes në popull;
- Rishikimi i kalendarit të kujtesës në bazë të aktiviteteve të parashikuara;
- Angazhimi i grupeve të interesit në aktivitetet me fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin qytetar.
- Përfshirja e të rinjve në aktivitetet me temë rishikimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që e vuajtën regjimin totalitar dhe të zhdukurve në komunizëm.
- Vënia në dispozicion të studiuesve dhe medias, konform ligjit 45/2015, i ndryshuar, neni 36 e në vazhdim, e dokumenteve të administruara nga AIDSSH, për trajtimin dhe studimin në thellësi të ngjarjeve historike.

2. Aktivitete të kryera

Për qëllim të edukimit qytetar, sipas kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit e ndërgjegjësimit të shoqërisë, janë organizuar dhe mbështetur një sërë veprimtarish. Duke iu përshtatur kushteve të krijuara nga pandemia Covid 2019, nga marsi në dhjetor 2020, për veprimtaritë është koordinuar infrastruktura përkatëse, janë përgatitur ftesa, programe, shpërndarje dhe informacione e njoftime për shtyp, për komunikim të zgjeruar me partnerët dhe publikun e interesuar:

Vizitë e Autoritetit në IPN, Instituti Polak Kombëtar i Kujtesës

Përvoja polake në zbardhjen e së shkuarës dhe rikthimin e dinjitetit viktimave të totalitarizmit

AIDSSH dhe përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë zhvilluan një vizitë pune në Varshavë më 3-6 shkurt, me ftesë të Institutit Kombëtar të Kujtesës në Poloni, Institute of National Remembrance- Instytut Pamieci Narodowej.

Më 4 shkurt dhe 5 shkurt, delegacioni shqiptar u prit nga drejtues të kërkimeve historike në IPN, z. Jerzy Bednarek, z. Rafal Leskiewicz, znj. Agnieszka Jedrzak, drejtuese e departamentit të marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Presidentit të IPN, zv/Presidenti i Institutit Kombëtar të Kujtesës, njëherësh zv/ Drejtor i Kërkimit Shkencor dhe i Plotfuqishëm për krimet e kryera ndaj kombit polak, z. Krzysztof Szwagrzyk.

Veprimtaria e Autoritetit, shtyllat mbi të cilat institucioni organizon punën e vet dhe mundësitë për bashkëpunim, u trajtuan nga kryetarja, znj. Gentiana Sula, dhe anëtarët,

z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi dhe z. Altin Hoxha. Ligji 45/2015 funksional dhe ndryshimet e propozuara për përmirësimin e tij në zbardhjen e së shkuarës, shërbimit të dokumentacionit qytetarëve, verifikimit të figurave dhe edukimit qytetar u diskutuan nga z. Skënder Vrioni, sekretar i përgjithshëm dhe znj. Mirela Lame, shefe e sektorit juridik, me praninë e deputetëve të Komisionit të Ligjeve, znj. Artemis Dralo dhe z. Edmond Leka.

Përvoja e konsoliduar e Institutit Kombëtar Polak të Kujtesës, njëherësh Komisioni për Ndjekjen e Krimeve Kundër Popullit Polak i vjen në ndihmë Autoritetit në përballje me të shkuarën komuniste dhe trajtimin e saj në të sotmen, në respekt të të dënuarve të ndërgjegjes, viktimave, të mbijetuarve dhe nxitjes së dialogut shoqëror për demokraci. Mes këtyre, përvoja e tij në fushën e të zhdukurve, që nga viti 1998 kur nisi ky proces me të zhdukurin e parë, duke vazhduar me identifikimin e gjetjen e varrezave masive edhe në mes të qyteteve kryesore, për të vazhduar me kërkimet sistematike.

Sot, IPN është institucion i konsoliduar me përvojë 20-vjeçare, me 2500 punonjës dhe 16 zyra lokale në mbarë vendin, i organizuar sipas tre drejtimeve kryesore: arkivi, prokuroria dhe kërkimi shkencor. Arkivi me parametra bashkëkohorë administron informacion të pasur, që kontribuon në rezultatet e punës së departamenteve të tjerë, prokurorisë, kërkimit shkencor, botimeve e më gjerë. Prokuroria me 135 prokurorë, shërbim burgjesh dhe komisioni mbi krimet e nazistëve për vitet 1945-1985 heton punën e institucionit të ish-policisë sekrete, pjesë e Ministrisë së Sigurisë Publike 1945-1954. Pas përfundimit të punës hetimore, Gjykata jep vendimin përfundimtar. Brenda Prokurorisë ekziston një sektor për lustracionin/vetingun, i cili trajton rreth 300.000 kërkesa në vit. Drejtuesi i Prokurorisë brenda Institutit Kombëtar të Kujtesës është njëherësh zv/Ministër i Drejtësisë. Prokuroria ka çuar në proces gjyqësor rreth 10.000 çështje për genocid, krime kundër njerëzimit dhe krime kundër kombit polak. Në vitin 1991, personave të dënuar gjatë regjimit komunist iu dha pafajësia me ligj të veçantë.

Kërkimi shkencor është departament ku organizohen drejtimet e punës kërkimore, edukimit, memorialeve, kërkimit të eshtrave (sektor i posaçëm për kërkimin e të zhdukurve, me arkeologë, teknikë e mjekë ligjorë). Pjesë e Institutit është edhe sektori që propozon dhënien e medaljes "Kryqi i Lirisë dhe Solidaritetit" për qytetarët që u përballën me dinjitet njerëzor me totalitarizmin dhe mekanizmat e shtypjes.

Përvoja polake në trajtimin e së shkuarës, përballjes me të dhe modeli i një institucioni kujtese që mbështet dinjitetin njerëzor dhe nxit dialogun shoqëror, - duke i trajtuar në thellësi plagët e së shkuarës, për të siguruar të tashmen e të ardhmen, - është e rëndësishme për një institucion si AIDSSH dhe kontributin e tij në mbajtjen gjallë të kujtesës kolektive.

Pjesëmarrje e AIDSSH në ENRS, Varshavë, Poloni

Më 6 dhe 7 shkurt, në Varshavë, Autoriteti u përfaqësua nga Kryetarja Sula në Rrjetin Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit, në takimet e përvitshme të Rrjetit, në të cilat mori pjesë edhe Ministrja e Kulturës e Shqipërisë, znj. Elva Margariti.

Konferenca ndërkombëtare shkencore me temë "Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990", Tiranë, 19 shkurt 2020

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, Muzeun Historik Kombëtar, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Europës dhe Institutin "Ali Hadri" Prishtinë zhvilloi konferencën ndërkombëtare shkencore me temë "Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990".

Konferenca dhe ekspozita dokumentare mbi emigracionin u prezantuan përgjatë datës 17 shkurt në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Për konferencën mbi emigracionin politik, Autoriteti dhe MEPJ ekspozuan dokumente të shumta arkivore, si pasqyra statistikore për të arratisurit, dosje drejtimi dhe kërkimi për të arratisur e të deklasuar, regjistra për personat në tentativë arratisjeje dhe albume fotografike të të arratisurve, që u përkasin qyteteve të ndryshme të vendit. Materialet arkivore janë pjesë e një fondi të pasur mbi emigracionin

politik, që u është vënë në dispozicion studiuesve, mes të cilave, ngjarjet e ambasadave, organizatat politike, historia e familjes Popa dhe dosje mbi të arratisurit. U paraqitën fakte mbi qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj veprimtarisë së të ashtuquajturit "emigracion reaksionar" jashtë vendit, Komiteti "Shqipëria e Lirë", harta gjeografike e shpërndarjes së tij, propaganda dhe antipropaganda e përgatitur për t'u përdorur në çdo situatë, emigracioni i vjetër politik dhe shtimi i radhëve të tij me të arratisur të tjerë nga Shqipëria.

Znj. Gentiana Sula, kryetare, bëri një paraqitje të punës së Autoritetit që çoi në realizimin e konferencës së parë mbi emigracionin politik, në bashkëpunim me partnerët. Mbajtën fjalën e tyre z. Bernd Borchardt, ambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Koordinatori i Përhershëm i OKB në Shqipëri, z. Brian Williams dhe Ministri i Diasporës, z. Pandeli Majko, duke e lidhur emigracionin e sotëm me atë të para '90-s, duke paraqitur dallimet thelbësore të tyre dhe rrëfyer përvojën personale me të arratisur në familje përgjatë diktaturës.

Z. Ermal Frashëri, anëtar i Komitetit të Punëtorëve Migratorë në OKB, z. Gjon Radovani, arkitekt, i larguar me ambasadat në 1990, dhe z. Dritan Sejko, kryetar i shoqatës "Çamëria", trajtuan tema të lidhura me përvoja të kaluara dhe personale me emigracionin.

Në vijim, konferenca trajtoi punimet shkencore të periudhës 1944-1955, në moderimin e Prof. Asoc. Dr. Pranvera Dibra. Studiuesit Beqir Meta, Dorian Koçi, Hamit Kaba, Enriketa Pandeleimoni, Romeo Gurakuqi dhe Leonora Laçi trajtuan tema, si: Vatra dhe regjimi komunist: nga partneriteti në armiqësi; Emigracioni politik shqiptar 1945-1953 përmes dosjeve të UDB-së; Emigracioni politik në SHBA pas Luftës së Dytë Botërore:

Raportet me 'emigracionin e vjetër'; Qëndrimi i Italisë ndaj operacionit 'Rollback'; "Kriminelët e luftës": Emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945 – 1955; Komiteti Kombëtar "Shqipëria e lirë" dhe veprimtaria e emigracionit në vitet 1949 – 1953; Blloku kombëtar indipendent, i drejtuar nga Ernest Koliqi;

Paneli i periudhës 1955-1990 u moderua nga prof. Hamit Kaba, duke trajtuar kumtesat e studiuesve Pranvera Teli (Dibra), Gjon Boriçi, Fatmir Arifi, Albulenë Halili, Mrika Limani, me tema si: Epilogu i diktaturës, nga 'terrorist' në 'të padënueshëm' ndante vetëm një det; Rrëmbimi i peshkarexhës 'Dukati' për arratisje në Itali, 6 janar 1989; Përpjekjet e Sigurimit të Shtetit për të vënë në kontroll emigracionin politik shqiptar në vitet 1945 – 1974; Emigracioni politik shqiptar, roli dhe ndikimi i strukturës shtetërore (Misioni në OKB, ambasadat, konsujt dhe diplomatët) në qasjen ndaj tij; Roli i emigracionit politik shqiptar nga Kosova në demaskimin e regjimit totalitar jugosllav; Emigracioni shqiptar nga Kosova në Europën Perëndimore në vitet 1960 – 1970, sipas burimeve të qeverisë shqiptare; Ngjarjet e korrikut 1990 dhe përpjekjet e regjimit për ta minimizuar impaktin e tyre politik; Organizimet dhe platformat politike të emigracionit shqiptar të Kosovës në vendet gjermanofone gjatë viteve 1981-1989;

Paneli përmbyllës, mbi kujtesën, letërsinë dhe emigrimin, i moderuar nga z. Gjon Boriçi, vijoi me kumtesat e Kristale Ivezajt, Elma Ndrecës, Enis Sulstarovës, Lekë Tasit, Andrea Llukanit me tema si: Projekti "Edhe muret kanë veshë"; Refleksione për eksodin e 2 korrikut 1990 dhe "Rrugën e Ambasadave"; Dritëhijet e veprimtarisë politike të shkrimtarëve të arratisur; Emigracioni politik në letërsinë e realizmit socialist; Emigracioni antikomunist 1944 – 1990; Dritëhije mbi aktivitetin politik të peshkopëve ortodoksë Kurila dhe Kotoko në emigracion.

Secili prej sesioneve u ndoq nga diskutime të të pranishmëve dhe sugjerime për zgjerimin e tematikës e trajtimin e thelluar të saj, nga studiuesit në Shqipëri e Kosovë, si dhe ata jashtë vendit.

Në 30-vjetorin e ndryshimeve demokratike në vend, konferenca mbi emigracionin politik hedh dritë në një Shqipëri të survejuar, shumë të përfolur e të keqinterpretuar për vite me radhë. Botimi i kumtesave të plota, të bazuara mbi dokumentacion arkivor të zgjeruar, të cilat shtojnë burimet zyrtare mbi periudhën e diktaturës, ndihmon transparencën mbi të shkuarën, nxitjen e dialogut shoqëror dhe konsolidimin e demokracisë.

Takim i ekipit të AIDSSH me kryetaren e Bashkisë Kurbin, znj. Majlinda Cara për Dialogun e ardhshëm lokal në zonë, qershor 2020.

Vizitë e Ambasadores së SHBA-ve në Shqipëri, znj. Yuri Kim, në AIDSSH, 26 qershor

Ambasadorja e SHBA-ve në Shqipëri, znj. Yuri Kim, vizitoi Autoritetin për Informimin për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Kryetarja, znj. Gentiana Sula, e njohu ambasadoren znj. Yuri Kim dhe z. Lan Crawford, shef i seksionit politik dhe ekonomik, me veprimtarinë e Autoritetit, shtyllat ku mbështetet puna e institucionit dhe sfidat e përditshme.

Z. Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm i AIDSSH, paraqiti nismat e institucionit për ndryshimin e kuadrit ligjor të Autoritetit.

Në takim, znj. Sula e vuri theksin te çështja e mijëra të zhdukurve me forcë në komunizëm dhe veprimtaria e AIDSSH për qartësimin e fatit të tyre. Përtej hapave konkretë në këtë drejtim dhe projekteve të ndërmarra, janë të nevojshme ndërhyrje ligjore që e lehtësojnë procesin e kërkimit, identifikimit dhe zhvarrimit të viktimave, dhe bashkërendojnë punën e institucioneve. Nga ana e tij, z. Simon Mirakaj, anëtar i Autoritetit, veç sfidave me të cilat përballet institucioni, foli për historinë e tij të përndjekjes, internimin në kampin e Tepelenës që pas lindjes dhe jetën e shkuar në fshatrat e internimit në Lushnjë, me mijëra të dënuar e të ndëshkuar të tjerë.

Ndërkohë, Autoriteti, i mbështetur në vite nga partnerë e homologë për veprimtaritë komplekse, ka punuar sistematikisht për kthimin e vëmendjes në kampin me tela me gjemba të Tepelenës, me aktivitete të përvitshme me praninë e të mbijetuarve të kampit dhe familjarëve të tyre, studiuesve, grupeve të interesit dhe të rinjve, për muzealizimin e tij dhe bërjen të vizitueshëm për të gjithë.

Takime të zhvilluara në Shkodër, qershor 2020

*Dorëzim i dosjes së përndjekjes nga ish-Sigurimi i Shtetit Dom Gjergj Simoni (Hardhia);

*Vizitë në Muzeun të Kujtesës, për projekte të ardhshme në Shkodër

*Takim me kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, për Dialogun lokal në Shkodër.

Aktivitet në fshatin Gostimë të Bashkisë Cërrik, 21 korrik 2020

Profile njerëzore të mbijetesës e dinjitetit

Dokumentari "Persekutimi i "kulakëve" në diktaturë, Shaban Plaka", i gazetares Luljeta Progni, u prezantua në fshatin Gostimë të Bashkisë Cërrik, në një aktivitet të hapur për mediat.

Dokumentari u realizua mbi materialet arkivore mbi familjen Plaka, vëllezërit Shaban dhe Ibrahim, të tërhequra nga familjarët pranë Autoritetit, si dhe dëshmitë e familjarëve, për t'u shfaqur në fshatin e lindjes, në 45-vjetorin e vdekjes së Shaban Plakës, pas njohjes së familjes me dokumentacionin përkatës në dokumente dhe zbardhje të bashkëpunëtorëve. Përfaqësues të Autoritetit, komunitetit të të përndjekurve të zonës dhe shoqatave të të drejtave të njeriut, familjarë dhe bashkëfshatarë përkujtuan figurën e Shaban Plakës, në fshatin e tij, Gostimë, ku familja ka pasur kontribute të njohura.

Dokumente dhe materiale arkivore të Autoritetit janë vënë në dispozicion të qytetarëve, familjarëve të të dënuarve politikë, studiuesve dhe gazetarëve, sipas kërkesës. Hulumtimi në materiale arkivore ka prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, filma dhe dokumentarë, speciale dhe ekskluzive, si bashkëpunime të Autoritetit me institucione partnere, organizata apo individë, për të rritur ndërgjegjësimin për krimet e komunizmit, për të inkurajuar dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit e familjarët e tyre, mediat dhe publikun e gjerë.

Making Memory Alive Together, ENRS, 13-16 gusht 2020
Projekt online në anglisht

ENRS propozoi për AIDSSH dhe partnerët europianë një projekt të përbashkët *online*, në kushtet e pandemisë. Materialet e përgatitura nga Autoriteti në gjuhën angleze ishin përmbledhje e projektit dhe botimit "Kur Sigurimi merrej me shkencë" dhe video e ekspozitës "E shkuara e pakryer-të zhdukur në diktaturë" dhe u shpërndanë nga ENRS, më 13 dhe 16 gusht.



Vizitë përkujtimore në kampin e internimit në Tepelenë, 23 gusht 2020
Pelegrinazhi i përvitshëm i dhimbjes në Tepelenë, me përfaqësues të AIDSSH, mes të mbijetuarve që mblidhen çdo vit, për Ditën në Përkujtim të Viktimave të Regjimeve Totalitare.

Tryeza e rrumbullakët "95 vjet Martin Camaj, vepra dhe përndjekja", 28 gusht 2020

"Në fjalë sqarohet qiell e dhé bashkë"

Martin Camaj

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Institutin e Historisë, Shtëpinë botuese "Onufri", Shoqatën "Martin Camaj" në Gjermani, Teatrin "Migjeni" Shkodër dhe Autoritetin Gjerman të Hapjes së Dosjeve (BSTU Gjermani), në kontakt me familjarë e bashkëpunëtorë të Camajt dhe studiues të tij, organizoi më 28 gusht tryezën e rrumbullakët "95 vjet Martin Camaj, vepra dhe përndjekja", takim i hapur për mediat.

Të pranishëm në tryezë, me zërin dhe qëndrimet e veta ishin familja, bashkëpunëtorët e afërt, pasuesit e punës së tij si albanolog, studiues të jetës, historianë, dhe të krijimtarisë së tij, akademike, letrare, gjuhësore, artistike, studiues që kanë tërhequr dosjen e tij ose janë shprehur në lidhje me të. Kryeministri i vendit, z. Edi Rama, mori pjesë në tryezë dhe mbajti fjalën e rastit, duke shprehur konsideratë për



punën e Autoritetit dhe inkurajuar projektet që i përcjellin më shumë publikut shqiptar.
Takimi u hap nga Kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, e pasuar nga një material audioviziv ku u prezantuan jeta, vepra dhe përndjekja e albanologut Camaj.
Dr. Erika Camaj, bashkëshorte e Prof. Martin Camajt dhe kryetare e nderit të shoqatës mori pjesë në tryezë me fjalën përshëndetëse, të lexuar nga Zuzana Finger, përkthyese dhe kryetare e Shoqatës "Martin Camaj" në Gjermani. Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, drejtues i katedrës së Albanologjisë në Universitetin Ludwig Maximilian, Mynih, bashkëorganizator i aktivitetit dhe i pari studiues që bëri kërkesë pranë AIDSSH për dosjen e Camajt, paraqiti temën "Mbi veprimtarinë e Camajt në Mynih, korrespondenca me Koliqin", me shumë elementë të dhënë për herë të parë për të interesuarit.
Sesioni "Përndjekja", i moderuar nga z. Simon Mirakaj, anëtar i AIDSSH, vijoi me prezantimet e historianëve Erald Kapri dhe Sonila Boçi, me temë

"Martin Camaj në kontekstin e Luftës së Ftohtë" e "Faktet dhe opinionet në dosjet e Sigurimit të Shtetit, rasti i Camajt". Ardita Repishti paraqiti një trajtesë të Autoritetit për "Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për studiuesit dhe mediat" e pasuar nga znj. Dagmar Hovestadt e BSTU Gjermani, bashkëorganizatorë të aktivitetit, me sfidat 30-vjeçare të gjermanëve në përballje me dosjet e figurave historike, me temë "Mbi personalitetet dhe dosjet e tyre në shërbimet sekrete, përvoja me dosjet e ish-Stasit në Gjermani". Sesioni i fundit iu kushtua veprës së gjithanshme të Martin Camajt. Z. Bujar Hudhri, botues i Camajt në Shqipëri solli përvojën e vet të botimit dhe marrëdhënien me institucionet.
Në lidhje të drejtpërdrejtë nga Miçigani, z. Lisandri dhe znj. Aristea Kola trajtuan "Mendimin kritik të Arshi Pipës mbi veprën "Dranja" të Martin Camajt", një prezantim interesant e shumëplanësh i diktaturës, të shkuarës e së ardhmes në një vepër me simbolikë të spikatur.
""Vetjet" komplekse të krijimtarisë së Camajt" u trajtuan me profesionalizëm nga kërkuesja shkencore znj. Adriana Duka, një ndër kërkueset e dosjes së tij pranë Autoritetit, në kuadër të hulumtimeve për veprën e shkrimtarit. "Profecia sociolinguistike e Camajt" u prezantua nga Prof. Ledi Shamku, me të gjitha ngjyrimet për të cilat dukej se Camaj ishte i qartë që në krye të herës, që të tre koinetë gjuhësore, deri te ndikimi i gjuhës nga shoqëria dhe gjetja e mënyrave të reja të shprehjes.
Znj. Rita Gjeka, drejtuese e Teatrit "Migjeni" Shkodër, bashkëorganizator i aktivitetit, foli për "Camajn në skenë". Në vitin 2015, Teatri

"Migjeni" shfaqi premierë botërore dramën e Camajt "Kandili i argjandit", vepër "poetike", siç u shpreh Gjeka, për nga mënyra e të shkruarit, saktësia e fjalëve dhe përjetimet e mesazheve të saj universale. "Sintaksa e Martin Camajt - pasuri e papërsëritshme e gjuhës shqipe" e përgatitur nga znj. Majlinda Bushaj do të jetë pjesë e botimit të dedikuar për 95-vjetorin e Martin Camajt.

Në mbyllje, për të pranishmit u shfaq drama e regjistruar nga teatri "Migjeni" Shkodër "Kandili argjandit", që trajton marrëdhënien e vështirë të atyre që u quajtën "klasa të përmbysura" me pushtetin dhe Sigurimin e Shtetit.

Në tryezën e zhvilluar në Pallatin Presidencial, u ftuan përfaqësues të institucioneve homologe me të cilat AIDSSH bashkëpunon që prej krijimit; institucione dhe organizata homologe, trupi diplomatik, përfaqësues të institucioneve publike, qendrore e lokale, shoqatave të të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë; përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve kërkimore në vend; mbi 50 studiues që janë shprehur publikisht për Camajn dhe që kanë tërhequr dosjen e tij pranë AIDSSH; gazetarë dhe përfaqësues të medias, për të shkëmbyer këndvështrime mbi figurën e albanologut dhe për t'i trajtuar figurat e personalitetet historike në dimension të gjerë.

Përgjatë aktivitetit u paraqit një ekspozitë e zgjeruar dokumentare e AIDSSH me tipologji të ndryshme të dosjeve të Sigurimit të periudhës 1944-1955, historikë, raporte, platforma, evidenca operative të kohës dhe dosje të mbi njëzet intelektualëve të përndjekur nga Sigurimi në Shqipëri dhe jashtë vendit. Po ashtu, krijimtaria letrare e Martin Camajt, e botuar nga Onufri.

Publikimi i studimeve mbi mendimin politik të së majtës shqiptare

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacioni "Friedrich Ebert" në Tiranë kanë bashkëpunuar prej një viti për realizimin e botimit shkencor të fokusuar tek e *"E Majta. Mendimi politik / Profile Biografike"*, i cili u finalizua në 2020, me publikimin në letër dhe *online* të studimeve të plota dhe publikimin e dytë si version i shkurtuar. Veç dy librave të "Së Majtës", versioni në anglisht i botimeve, i bën ato të njohura edhe për të interesuarit jashtë vendit.

Studime të thelluara arkivore u realizuan nga një ekip i nivelit të lartë akademik për të ndriçuar këtë aspekt të historisë sonë të afërt, nëpërmjet ndërtimit të profileve të dhjetë intelektualëve të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij.

4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskicuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi, Petro Marko, Xhavit Qesja, Isuf Keçi, Zef Mala e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend, si e majtë europiane.

Po ashtu, botimi është ftesë për reflektim dhe mundësi që shoqëria e të rinjtë të njihen me individë me identitet politik të qartë, të përcaktuar dhe të dallueshëm, që janë pjesë e trashëgimisë historike të Shqipërisë. Aktivitetet promovuese të studimeve u shtynë për vitin 2021, për shkak të kufizimeve të pandemisë.

3. Projekte në proces

- **Tirana 100, Dialogu për Tiranën;**
  Firmosur marrëveshje bashkëpunimi, tërhequr dokumentacion i pasur nga Autoriteti për krijimin e profileve të Tiranës
- Promovim i studimeve për **Mendimin politik të së majtës shqiptare**;
  Botuar versioni i gjatë dhe i shkurtër, në proces varianti anglisht.
  Mbeten për t'u realizuar aktivitetet promovuese të studimeve, simpoziumi shkencor, ekspozita e profileve përgjatë 2021, të mbetura pezull për shkak të kufizimeve të pandemisë.
- **Dialogët lokalë në Korçë e Maliq**, organizimet përkatëse;
  Plotësuar dokumentacioni përkatës nga AIDSSH, dorëzuar në Presidencë, realizuar komunikimet në terren dhe shkresat respektive me bashkitë.
- **Vlerësimi me tituj nderi** i personaliteteve të dinjitetit njerëzor dhe rezistencës në **Korçë e Maliq**, në Dialogët përkatës, plotësuar dhe dorëzuar dokumentacioni përkatës, në pritje të realizimit, pas zbutjes së kufizimeve të pandemisë.
- **Projekti ICMP-Autoriteti "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm".**

Më 10 gusht 2020, AIDSSH dhe ICMP firmosën marrëveshjen teknike të bashkëpunimit nr. 831/11, për projektin "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm", 2020-2021. Në vijim, AIDSSH ngriti grupin e punës për përgatitjen e termave të referencës për dy pozicionet, shkrues e raportues, arkivist dhe shkrues e raportues zyrtar grantesh. Po ashtu, përcaktoi personat përgjegjës për AIDSSH në marrëdhëniet me ICMP, Sekretari i Përgjithshëm dhe përgjegjësja e financës, sa u takon marrëdhënieve financiare. Thirrjet përkatëse u publikuan në faqen zyrtare dhe gjatë muajit shtator, tetor, Komisioni përgjegjës i përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve vlerësoi dy kandidaturat fituese, përkatësisht z. Marçel Hila dhe znj. Rovena Voda.

Dy koordinatorët kanë filluar të punojnë me plane të përcaktuara sa i takon aktivitetit përkatës për dokumentimin, ndërtimin e profileve të të zhdukurve dhe udhëzuesit për familjarët e të zhdukurve. Puna e tyre pasqyrohet në raportet 3-mujore të punës, sipas marrëveshjes dypalëshe, për:

1. Zhvillimin e një ekspozite duke përdorur fotografi dhe ekstrakte nga dosjet e Sigurimit të shtetit komunist. Ekspozita shfaqet në takimet me komunitetin në të gjithë Shqipërinë;
2. Mbledhjen e historive të treguara nga ish-të përndjekurit politikë dhe familjet e të zhdukurve dhe botimi i tyre në formë dorëshkrimi dhe elektronike, në gjuhët shqip dhe anglisht;
3. Hartimin dhe botimin e një Udhëzuesi për të drejtat e familjeve të të zhdukurve. Udhëzuesi siguron informacion për të drejtat dhe detyrimet, si në legjislacionin e brendshëm ashtu edhe në ligjin ndërkombëtar të zbatueshëm të të drejtave të njeriut, në lidhje me personat e zhdukur që pasuan dhunën politike dhe periudhën e abuzimeve me të drejtat e njeriut;
4. Organizimin e takimeve me komunitetin për të paraqitur Udhëzuesin për OShC-të, familjet e të zhdukurve dhe institucionet vendore.

4.Marrëveshje Bashkëpunimi

Më 10 janar u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis **Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Qendrës Memo**, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Ema Andrea, Drejtore ekzekutive e Memo. Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit së Shtetit, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në realizimin e projekteve të memories.
Më 16 janar 2019, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis **Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universitetit Europian të Tiranës**, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Nevila Nika, Rektore e UET. Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit së Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor. AIDSSH dhe UET do të punojnë për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore për aktivitete të kalendarit të kujtesës, nisma për edukimin qytetar, seminare, tryeza pune, etj. Bashkëpunimi synon të konsolidojë punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit me qytetarët.
Më 8 gusht 2020 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes **AIDSSH dhe ICMP** për projektin "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm", 2020-2021, bazuar në ligjin nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", Planin Strategjik 2017-2020 të Autoritetit, Rregulloren "Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", nenin 17 Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", miratuar në datën 08.05.2019, rekomandimin "Rritja

e bashkëpunimit me institucionet qeveritare për përfundimin sa më parë të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për të ruajtur dhe mbrojtur në mënyrë adekuate vendet që janë aktualisht të identifikuara si varreza masive".

Më 22 tetor u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis **Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Shoqatës "Tirana",** mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe z. Arben Tafaj, Kryetar i Shoqatës.

Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit së Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese që hedhin dritë në historinë gjysmëshekullore të Tiranës kryeqytet në diktaturë, studimit e hulumtimit në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit; mbledhjes së dëshmive të individëve dhe familjarëve që i përjetuan ndryshimet në vetë të parë; rindërtimit të një narrative të re, pas

përqasjes e grumbullimit të të dhënave për figura e personalitete të njohur të Tiranës, të survejuar, përndjekur e të përbaltur në diktaturë, si dhe evidentimit, përcaktimit dhe ruajtjes së vendeve të kujtesës, emërtimit të tyre, vënies së pllakateve, tabelave, ngritjes së memorialeve për nderimin e viktimave të diktaturës komuniste, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor.

- AIDSSH dhe SHISH nënshkruan marrëveshje me objekt bashkëpunimin për rregullimin e marrëdhënieve institucionale në fusha të interesit të përbashkët, si dhënie e asistencës në bazë të kërkesave të Autoritetit, lidhur me proceset e deklasifikimit të plotë, të pjesshëm dhe/ose përjashtim nga deklasifikimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, ekspozimi (bërja publike) i të cilave përbën cënim për sigurinë kombëtare; shkëmbimi i eksperiencës në funksion të realizimit sa më sipër, duke organizuar takime, seminare dhe pjesëmarrje në trajnime të përgatitura nga SHISH, me temë mbrojtjen e interesit publik, sigurisë kombëtare, si dhe pajtimit e unitetit kombëtar.

5. Botime

Autoriteti ka vijuar punën për botimin e buletinëve, raportit vjetor dhe librave me tematikë të dedikuar, që përmbajnë materiale të dosjeve të Sigurimit dhe trajtojnë në mënyrë komplekse figurat, personalitetet apo ngjarjet historike.

Është bërë mbledhja, anonimizimi, shkurtimi dhe organizimi i 6 buletinëve 2019 dhe 6 të 2020 (në total 1200 faqe A4), punë e koordinuar me të gjitha drejtoritë e Autoritetit. Versionet *online* të buletinëve, raportit vjetor, udhëzuesve, etj. janë tashmë në faqen zyrtare të AIDSSH dhe në faqen issuu. Me prokurimin e shërbimeve në fillim të 2021, i gjithë procesi finalizohet. Marrëveshja kuadër e punuar në 2020 për botimet, pritet në nxjerrë në dritë mbi 40 tituj me botime dhe ribotime të AIDSSH, mes të cilëve, përmbledhje të konferencave shkencore, dialogëve, raporte, buletinë, fletëpalosje, dëshmi, materiale të AIDSSH në anglisht, etj.

Ndërkohë, në bashkëpunim me FES, janë botuar në letër dhe *online* punimet shkencore të projektit "Mendimi politik i së majtës në Shqipëri" në versionin e plotë dhe atë të shkurtuar.

6. Përditësimi, përmirësimi, dhe mirëmbajtja e faqeve të Auroritetit

Marrëdhëniet e Autoritetit me publikun dhe të tretët janë mbajtur nga DMSHEQ, me staf që ka ardhur duke u zgjeruar gjatë vitit dhe ka ndikuar në paraqitjen më të mirë të faqeve zyrtare dhe mediave *online* të Autoritetit. Që në mes të vitit, DMSHEQ përgatit një kalendar paraprak publikimesh, që ndahet mes anëtarëve dhe të gjitha drejtorive të institucionit, si mundësi e pasurimit me informacion sa më të plotë. Si vit pandemie, 2020 ka pasur aktivitet shumë të plotë *online* të Autoritetit, sa i takon komunikimit me publikun, grupet e interesit, kërkimit shkencor, edukimit qytetar, pasqyrimit të marrëdhënieve me institucionet, hapat e punës për veprimtaritë e ndryshme të Autoritetit, e paraqitur ditë pas dite në njoftimet përkatëse për shtyp, të hulumtuara dhe të punuara nga DMSHEQ.

Paralelisht, në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik është përditësuar faqja zyrtare, www.autoritetidosjeve.gov.al. Është intensifikuar puna në komunikimin *online* të institucionit, me informacion mbi dosje, ngjarje dhe figura historike dhe hulumtimet përkatëse në faqet zyrtare në rrjet të Autoritetit, sipas kalendarit të kujtesës.

Janë pasuruar, përmirësuar dhe mirëmbajtur faqet e Autoritetit për ndërveprim sa më të mirë me ndjekësit, me postime të përditshme, hulumtime dhe shpërndarje të informacionit në të gjitha mediat *online*. Është mbajtur kontakt me gazetarët e interesuar.

Po ashtu, faqja www.dosjet.gov.al, e lidhur me faqen e Autoritetit, është shpërndarë gjerësisht me studimet, kohështrirjet dhe informacionin e trajtuar.

Janë krijuar video informuese mbi veprimtarinë e Autoritetit, të publikuara në faqet zyrtare. Po ashtu, janë publikuar online të gjitha botimet e Autoritetit, të mundësuara për të rinjtë e të interesuarit e tjerë.

Rreth 600 postime të përgatitura për rrjetet sociale në Facebook, Instagram dhe Twitter me tekst, me rreth 550 faqe për publikim. Përditësimi i rrjeteve sociale të AIDSSH është bërë me informacione mbi veprimtarinë, punë hulumtuese me dosjet dhe profilet e personaliteteve të shqyrtuara, apo ngjarjeve historike sipas kalendarit të kujtesës.

- Facebook: https://www.facebook.com/AutoritetiDosjeve/
- Instagram: Autoriteti Dosjeve (AIDSSH)
- Twitter: https://www.twitter.com/aidssh
- Youtube: Autoriteti i Dosjeve
- Issuu: https://issuu.com/aidssh

5.1.4 Siguria dhe Zhvillimi Teknologjik

5.1.4.1 Siguria fizike

Në funksion të zbatimit të ligjit nr. 45/2015, autoritetet publike i referohen dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për aq sa është e mundur, edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, arkivat dhe informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror". Autoriteti, gjatë veprimtarisë së tij është ndeshur me dokumente dhe informacione të klasifikuara dhe ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", sipas rastit dhe nivelit të klasifikimit.

Duke pasur parasysh se mbledhja, administrimi, përpunimi, përdorimi dhe informimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit udhëhiqet, ndër të tjera, edhe nga parimet e mbrojtjes së interesit publik e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar, është bërë plotësimi i kuadrit ligjor të brendshëm të institucionit, që ka të bëjë me mënyrën e ruajtjes fizike të dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, një nga prioritetet për çdo vit pune.

Autoriteti prodhon dhe administron informacione të klasifikuara "sekret shtetëror", nga niveli më i ulët i klasifikimit "i kufizuar" deri në nivelin më të lartë të klasifikimit "tepër sekret". Këto kategori informacionesh trajtohen vetëm në zona të sigurisë të klasit të parë dhe të dytë.

Me qëllim garantimin e sigurisë për informacionin e klasifikuar që prodhohet dhe administrohet nga Autoriteti, janë rishikuar urdhrat në zbatim të VKM nr. 188, Datë 4.03.2015 "Për miratimin e rregullores "Për sigurimin e personelit"" dhe VKM nr.189, datë 4.03.2015 "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare".

Përsa i përket qarkullimit të informacionit të klasifikuar, janë identifikuar strukturat që prodhojnë secilin prej dokumenteve të klasifikuara sipas urdhrit nr. 68, datë 13.11.2017

"Për miratimin e listës së dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror"", me qëllim identifikimin e qartë të funksioneve që duhet të pajisen me CSP.

Gjatë vitit 2020 ka nisur faza e dytë e rikonstruksionit të godinës së re të Autoritetit, e cila ndodhet brenda territorit të Ministrisë së Mbrojtjes. Për aspekte të sigurisë fizike të godinës, si dhe për faktin se kjo godinë ndodhet brenda zonave të sigurisë të territorit të Forcave të Armatosura, sektori i sigurisë dhe qarkullimit të informacionit të klasifikuar ka ndjekur punimet në godinë, në funksion të vendosjes së parametrave dhe mjeteve të kërkuara, sipas vendosjes së zonave përkatëse të sigurisë dhe procedurave të miratuara nga Autoriteti.

Pas përfundimit të punimeve në katin nëntokë të godinës së re, mjedis i projektuar për arkiv, bazuar në vendimin e Autoritetit për zhvendosjen e dokumenteve arkivore nga ambientet e Shkollës së Përgatitjes së Qenve të Policisë në ambientet e arkivit pranë godinës së re të Autoritetit, janë ndjekur procedurat përkatëse për sigurinë fizike dhe transportin e materialit arkivor sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Gjithashtu, janë ndjekur procedurat e pajisjes së personelit me certifikatat përkatëse të sigurisë (CSP), duke ruajtur kontakte të vazhdueshme me DSIK për aspekte të sigurisë së informacionit të klasifikuar.

5.1.4.2 Zhvillimi teknologjik

Gjatë situatës së krijuar të pandemisë janë mundësuar mbledhjet e Autoritetit me Sekretariatin Teknik dhe mbledhjet e Autoritetit me institucione të tjera, si vijon:

- Platformën Zoom, për mbledhjet e Autoritetit dhe Sekretariatit Teknik. Kjo platformë u instalua dhe konfigurua tek



anëtarët e bordit, drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve pa drejtor. Aktualisht është platforma që përdoret nga Autoriteti.

- Lidhja me Webex me Parlamentin, gjatë raportimeve dhe gjatë mbledhjes së Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë me drejtuesit e institucioneve të pavarura.

Në kuadër të detyrave të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit është kryer pajisja e të gjithë punonjësve të rinj të AIDSSH me e-mail zyrtar në domain-in *autoritetidosjeve.gov.al*, konfigurimi i e-mailit zyrtar në të gjithë kompjuterët e stafit, si dhe përditësimi i fjalëkalimeve sipas rregullores së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Është kryer mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe pajisjeve përkatëse, duke ndërhyrë në raste problematikash apo të shtimit të stafit.

Në bashkëpunim me DMSHEQ, është kryer mirëmbajtja e faqes zyrtare të institucionit ***www.autoritetidosjeve.gov.al***, me publikime të reja, përditësime, përmirësime, etj, në faqe janë pasqyruar periodikisht informacione mbi aktivitetet e Autoritetit, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, publikime për vende të lira pune, formularë për aplikime, materiale të përgatitura nga stafi, etj., me qëllim arritjen te një numër sa më i madh qytetarësh-përdorues të faqeve *online* për marrjen e informacionit të plotë e të besueshëm.

Faqja zyrtare web e institucionit www.autoritetidosjeve.gov.al gjatë periudhës janar - dhjetor 2020 është aksesuar:

- nga 3465 përdorues
- janë hapur 6729 sesione
- janë parë 16.606 faqe të ndryshme, me lexueshmëri mesatare 3.42 minuta për faqe.

Po kështu, është mirëmbajtur domaini ***dosjet.gov.al***, **"Edhe muret kanë veshë"** i dëshmive gojore, në shqip dhe anglisht. Të dy platformat janë lidhur me faqen zyrtare të Autoritetit. Po ashtu **Blogu "Muze Memorial Tepelenë"** *https://muzememorialtepelene.wordpress.com*, ku janë



publikuar të dhëna dhe materiale për Kampin e Tepelenës, i cili mirëmbahet, pasurohet dhe përditësohet në varësi të të dhënave. Është mbështetur me pajisje regjistrimi i dëshmive gojore dhe ruajtja e tyre, në pajisjet përkatëse të dhuruara nga Ambasada Gjermane, të konfiguruara në ambientet e institucionit.
Për konferencat shkencore krijohet një faqe web e dedikuar, me informacion të përmbledhur dhe të mirëorganizuar ***konferencashkencore.wordpress.com***, me temat, pjesëmarrësit, fituesit, abstraktet, bio-t e studiuesve, galeri fotosh, publikime, media, etj.
Platforma e publikimeve *online* **ISSUU** ka gjetur përdorim të gjerë përsa i përket paraqitjes *online* të të gjitha botimeve të AIDSSH. Është pasuruar profili i institucionit në platformë dhe vazhdon publikimi për çdo botim të ri që botohet, me përshkrim të shkurtër rreth përmbajtjes. Të gjitha botimet e AIDSSH në gjuhën shqipe dhe angleze janë në www.isssu/aidssh.com, e lidhur me faqen zyrtare për të lehtësuar aksesin në materialet e publikuara.

Në faqen ISSUU gjatë periudhës janar – dhjetor 2020

- janë bërë 24 publikime, me 791 lexime, me prirje të lartë në rritje gjatë muajve të fundit.

Në zbatim të Rregullores *"Mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj"* miratuar me vendim të Autoritetit nr. 88, datë 22.02.2019, vijon puna për publikimin online në faqen zyrtare të Autoritetit të të gjitha vendimeve dhe aktiviteteve të institucionit, si dhe vendimet e KDZH-së për deklasifikimin e dokumenteve, në bashkëpunim me koordinatorin e publikimeve dhe grupin e punës.

5.2 Objektivat e institucionit për vitin 2021

Objektivat kryesorë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2021:

1. Rritja e kapaciteteve administrative, plotësimi i strukturë/organikës së AIDSSH-së;
2. Përmirësimi i infrastrukturës, përfundimi i rikonstruksionit të godinës sipas projektit të hartuar nga Instituti i Ndërtimit;
3. Përfundimi i procesit të marrjes në dorëzim të të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore në vend;
4. Deklasifikimi në total të dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare;
5. Indeksimi digjital i mbarë dokumentacionit të administruar;
6. Fillimi i punës për krijimin e sistemit të arkivit digjital, për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore;
7. Përmirësimi i procedurave të brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale dhe studimore;
8. Zhvillimi i procedurave për trajtimin dhe përmbylljen e 1000 kërkesave në vit në total, nga të gjitha drejtoritë;
9. Shkurtimi i afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit, në funksion të përgjigjes së kërkesave të paraqitura nga subjektet e interesuara;
10. Organizimi i veprimtarive hulumtuese dhe ndërvepruese, sipas planit të miratuar dhe kalendarit të kujtesës;
11. Realizimi i konferencave shkencore, dialogëve lokalë, ekspozitave dokumentare dhe të profileve njerëzore, brenda dhe jashtë vendit;
12. Zbatimi i strategjisë së komunikimit në vend dhe jashtë tij, me grupet e synuara, partnerët dhe homologët për zbardhjen e së shkuarës;
13. Finalizimi i suksesshëm i projekteve të nisura gjatë vitit 2020.
14. Bashkëpunimi me institucionet, organizatat kombëtare e ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë në proceset e drejtësisë tranzicionale.
15. Ridimensionimi i figurave dhe personaliteteve, bazuar në kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me partnerë.
16. Trajtimi i çështjes së të zhdukurve në fushën e veprimit të institucionit, përmes akteve ligjore përkatëse;
17. Publikimi dhe shpërndarja e vendimeve, buletinëve, studimeve dhe hulumtimeve shkencore.
18. Krijimi dhe pasurimi i platformave funksionale e ndërvepruese që qarkullojnë informacionin mbi veprimtaritë e AIDSSH, të përshtatura për të gjitha grupet e synuara, në shqip dhe anglisht.

5.3 Synimet për të ardhmen

AIDSSH udhëhiqet nga misioni ligjor për dhënien e informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, që edukon shoqërinë me vlerat demokratike të drejtësisë, së vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për brezat e ardhshëm, ku përkujtimi synon mospërsëritjen e së shkuarës. Vizioni i Autoritetit është përshtatja me modelet e institucioneve homologe të vendeve ish-komuniste, ku AIDSSH:

1. Është një platformë e besueshme nga ku aksesohet trashëgimia dokumentare e ish-Sigurimit të Shtetit, nga brenda e jashtë vendit, në mundësinë për të kërkuar të dhëna, informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit mbi përvojën e shtypjes komuniste;
2. Ndërton një sistem të sigurt teknologjik të shërbimit të të dhënave, sipas standardeve ndërkombëtare, që lehtëson kërkimin, gjurmimin dhe studimin e informacionit arkivor.
3. Shërben si burim institucional për të vlerësuar përvojën shqiptare në komunizëm, në mënyrë që ajo të mos përsëritet në të ardhmen.
4. Rrit ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist, duke dhënë informacion mbi veprimtarinë e Sigurimit dhe kontekstin përkatës, duke ndihmuar në parandalimin e intolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve antidemokratike dhe përsëritjen e totalitarizmit;
5. Mbështet dhe nxit angazhimin publik, duke mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës dhe pajtimit, duke krijuar mjedise të posaçme për leximin, studimin dhe ekspozimin e materialeve arkivore dhe studimeve për periudhën 1944-1991.
6. Inkurajon programe edukuese, shkollore, akademike, në disa nivele, pranë dhe për Autoritetin, dhe dokumentacionin e administruar në AIDSSH.
7. Mbështet diskutimet e hapura dhe dialogët lokalë për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj, bazuar në transparencë, integritet, bashkëpunim me individë dhe institucione qendrore e të pushtetit lokal.
8. Mbështet trajtimin profesional të pasojave të traumës në viktimat e dhunës gjatë komunizmit, me programe të posaçme mbi trajtimin e viktimave, familjarëve, pasardhësve për gjurmët e së shkuarës në realitetin me të cilin përballen.
9. Ndërton bashkëpunime ndërinstitucionale për vënien në vend të dinjitetit të viktimave, personave të thjeshtë apo personaliteteve të përndjekur në diktaturë, të cilët vijojnë të mbajnë stigmën e propagandës komuniste për shtrembërimin e profilit personal e shoqëror në letërsi, art, kinematografi, histori, etj.
10. Ndërmerr hapa institucionalë për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me

familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare, me institucionet shqiptare të ngarkuara për këtë qëllim.

11. Mbështet punën për dokumentimin e krimeve të komunizmit, përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë.

06

DETYRIMET LIGJORE NGA AIDSSH DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR

Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, Autoriteti është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nuk ka pasur raste të tejkalimit apo keqpërdorimit të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat ligji nr. 45/2015, i ndryshuar dhe Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit e ngarkojnë.

07

NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR VITIN 2020 DHE EFEKTET E TYRE

Plani vjetor 2020 përcaktoi drejtimet kryesore të Autoritetit **për përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligjin nr. 45/2015, në VKM-në nr.** 98/2017 *"Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e AIDSSH të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike",* në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore **që normojnë veprimtarinë e institucionit, si dhe në Planin Strategjik dhe atij të veprimit (2017-2020). Në përmbajtje të planit vjetor të çdo** drejtorie/sektori u vendosën objektivat, aktivitetet që do të zhvillohen për të arritur objektivat, afati kohor, struktura përgjegjëse që do të realizojë objektivat, si dhe dokument provues për arritjen e objektivave.

Sa më sipër, Autoriteti në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për të bërë më të qartë e transparente vendimmarrjen dhe veprimtarinë e tij, ka hartuar një sërë rregullash dhe normash që i vijnë në ndihmë mirëfunksionimit të institucionit, të cilat kryesisht janë si më poshtë:

- Vendimi i Autoritetit për miratimin e Udhëzuesit të planit të masave organizative dhe administrative nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë (AIDSSH) në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19;
- Vendimi i Autoritetit për miratimin e Planit vjetor të veprimtarisë për vitin 2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

Njëherazi gjatë vitit 2020 janë përgatitur dhe nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe shoqata si më poshtë:

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit – AIDSSH, miratuar me vendimin nr. 391, datë 23/07/2020;
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Qendrën MEMO, miratuar në mbledhjen e Autoritetit me nr. 212/1 datë 10/1/2020 me vendimin nr. 777, datë 17/12/2019 të Autoritetit;
3. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Shoqërinë "European Education Initiative" shpk – Universiteti Europian i Tiranës" - UET, miratuar në mbledhjen e Autoritetit me vendimin nr. 676, datë 25/10/2019 të Autoritetit;
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institutin e Integrimit të ish-të Përndjekurit Politik**ë**, me nr. prot. 492, datë 21.06.2018, e ndryshuar dhe miratuar në mbledhjen e Autoritetit me vendimin nr. 50/1, datë 15/1/2020;
5. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet AIDSSH dhe Shoqatës "Tirana", miratuar në mbledhjen e Autoritetit më 22 tetor 2020;
6. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet SHISH dhe Autoritetit, me objekt bashkëpunimin e Autoritetit me SHISH, për rregullimin e marrëdhënieve institucionale në fusha të interesit të

përbashkët, nënshkruar me datë 7 dhjetor 2020 me nr.125 prot.,

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 janë miratuar një sërë urdhrash të nxjerrë nga titullari i institucionit, në aspektin organizativ dhe funksional, të cilët kryesisht normojnë dhe disiplinojnë veprimtarinë e Sektretariatit Teknik në Autoritet, në bazë të ligjit organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku vlen të përmendet urdhri nr.6. datë 16.01.2020 "Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe personave privatë për informim pranë Autoritetit".

08

MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIMTARINË E AIDSSH-SË ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE



Një nga tre drejtimet kryesore ku është fokusuar veprimtaria katërvjeçare e Autoritetit, është vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, proces që përfshin shumë institucione dhe zyrtarë.

Një nga tre drejtimet kryesore ku është fokusuar veprimtaria katërvjeçare e Autoritetit, është vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, proces që përfshin shumë institucione dhe zyrtarë, si Presidenti i Republikës; anëtarë të Këshillit të Ministrave, funksionarë politikë, deputetë, anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarë e prokurorë në gjykatat e prokuroritë e të gjitha niveleve; anëtarë të Gjykatës Kushtetuese; funksionarë në Forcat e Armatosura, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Garda e Republikës, oficerë me gradën "Gjeneral" dhe "Kolonel"; drejtues dhe punonjës të Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes; drejtues në Policinë e Shtetit, drejtues të përfaqësive diplomatike, etj., lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Ligji nr. 45/2015 (datë 30.04.2015) është miratuar në mars të vitit 2015. Por 18 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi, në nëntor të vitit 2016, filloi funksionimi i institucionit, kur Kuvendi i Shqipërisë me vendimet përkatëse, zgjodhi anëtarët e Autoritetit. Sipas dispozitave të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve duhet të përfundojë në vitin 2020, pra brenda afatit kohor 5 vjeçar. Në kohën e miratimit të ligjit nr 45/2015 u vlerësua se ishte e mjaftueshme dhe e rëndësishme që periudha pesëvjeçare e verifikimit të pastërtisë së figurës, e kufizuar nga standardet europiane dhe konventat për të drejtat e njeriut, të përfundonte në kohën e parashikuar në ligj, pra brenda vitit 2020.

Gjatë vitit 2020 për shkak të afatit fundor ligjor datës 31 mars 2020, për verifikimin e figurave të zyrtarëve para emërimit apo ngritjes në detyrë i parashikuar nga dispozitat e pikës 2 të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 45/2015 që normon veprimtarinë e Autoritetit, u ndërpre për disa muaj procesi i verifikimit të zyrtarëve në përgjithësi dhe në veçanti procesi i vetingut në polici, i cili ishte në hapat e para të zbatimit, pavarësisht numrit të kërkesave që vijonin të paraqiteshin në Autoritet nga institucionet kushtetuese, deri në miratimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 114/2020 datë 29.07.2020 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".*

Edhe pse paketa me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore për reformën në drejtësi hyri në fuqi në vitin 2016, me miratimin e ligjeve për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të reja, - (konkretisht ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve"; b) ligji nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"; ç) ligji nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"; d) ligji nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; dh) "ligji nr. 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë""; e) ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë") - ngritja e strukturave të reja të drejtësisë u bë më vonë. Sa më sipër, afati kohor i vendosur në dispozitat e ligjit nr. 45/2015 nuk ishte i mjaftueshëm për mbylljen e procedurës së verifikimeve të subjekteve, e lidhur kjo me faktin se nuk u konsumua koha e parashikuar 5-vjeçare, për shkak të ngritjes dhe funksionimit të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë proces (organet e vetingut në drejtësi dhe polici) me afate kohore të vonuara në kohë.

Në vitin 2019 krahas procesit të reformës në drejtësi filloi edhe procesi i vetingut në Policinë e Shtetit, i cili vijoi edhe gjatë vitit kalendarik 2020, me kërkesat e paraqitura nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, si organ i posaçëm i ngritur me ligjin nr. 12/2018 *"Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës...*" për të kryer këtë veprimtari, ndërkohë që duhet të verifikojë rreth 12.000 subjekte të Policisë së Shtetit. Por sipas nenit 27 dhe 28 të ligjit nr 45/2015, Autoriteti ishte në pamundësi për kryerjen e verifikimit dhe vënien në dispozicion të informacionit kërkues, kjo pasi afati fundor i vendosur në ligjin nr. 45/2015 që normon veprimtarinë e Autoritetit thekson se Autoriteti vë në dispozicion dokumentacion dhe lejon përdorimin e dokumenteve, për qëllime të verifikimit te zyrtarëve, në përputhje me kërkesat drejtuar Autoritetit nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike *deri në 31 mars 2020"*.

Bazuar në nenin 10 të ligjit 45/2015, ndër të tjera, Autoriteti ka përgjegjësi: grumbullimin

e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj; bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të këtij ligji.

Në këtë kuadër, në vitin 2017, AIDSSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Shërbimin Informativ Kombëtar dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Shërbimi Informativ Shtetëror ka përfunduar brenda afateve dorëzimin e dokumenteve, sipas VKM nr. 98/2017. Ministria e Brendshme, Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit. Zbatimi i marrëveshjes së përbashkët me Ministrinë e Brendshme vijon të jetë i bllokuar që prej muajit maj 2019. Ky institucion, edhe pse ligji 45/2015 e ka përcaktuar qartë detyrimin e institucioneve arkivore në Republikën e Shqipërisë në marrëdhënie me AIDSSH, vijon të refuzojë dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, të cilat ruhen si pjesë e fondeve arkivore të administruara nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme.

Me qëllim zgjidhjen e ngërçit të krijuar në lidhje me zbatimin e marrëveshjes së mësipërme, gjatë vitit 2020 janë realizuar disa takime ndërmjet përfaqësuesve të niveleve të larta dhe nivelit teknik, të Ministrisë së Brendshme dhe Autoritetit. Në kuadër të zhvillimit të këtyre takimeve, po shihet mundësia e zgjidhjes përfundimtare të problematikës së krijuar.

Në seksionin 3, "Informimi për qëllime kërkimore, historike dhe i medias", në nenin 36, pika 1 të tij, legjislatori vetëm sa e ka cekur edukimin qytetar, por nuk e ka zgjeruar atë në koncept dhe veprime për realizimin e tij. Ndërkohë që në rezolutat e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, midis të tjerave i është lënë detyrë detyrë Autoritetit që të përmirësojë punën në drejtim edhe të "vijimit të procesit të informimit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve, botimeve dhe në veçanti, pjesëmarrjes në media dhe rrjetet sociale, duke patur parasysh rolin e rëndësishëm që ato luajnë në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik". Në këto kushte, del e nevojshme përfshirja e mjeteve për të realizuar qëllimin e kërkuar për edukimin qytetar, në dispozitën përkatëse të ligjit 45/2015, në funksion të zhvillimit të një strategjie të hapur komunikimi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe gjeneratës së re mbi ngjarje tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshme të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bërë publike për herë të parë mbi dokumente autentikë nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit Autoriteti, prej dy vjetësh vazhdon të punojë në mungesë të një anëtari. Kjo si rezultat i vendit vakant të krijuar pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve. Në këto kushte, nëpërmjet komunikimeve zyrtare dhe raportimeve të veprimtarisë së institucionit para Komisionit të Çështjeve Ligjore, është kërkuar në vijimësi plotësimi i këtij vendi

vakant, në funksion të zhvillimit të mbledhjeve të Autoritetit me kuorum të plotë, duke propozuar si të domosdoshme përzgjedhjen e një anëtari profesionist në fushën juridike dhe administrative, pasi asnjëri nga anëtarët aktualë të Autoritetit, nuk është me arsim juridik dhe me eksperiencë në fushën e vendimmarrjes.

09

NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E AUTORITETIT DHE IMPAKTI I TYRE

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat e hasura gjatë viteve 2017- 2020, Autoriteti ka kryer me sukses dhe brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t´u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t'u zgjedhur në KLP, KLGJ, KED, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, anëtarë të Gjykatës së Lartë, etj.

Me gjithë vështirësitë dhe sfidat e hasura gjatë viteve 2017- 2020, Autoriteti ka kryer me sukses dhe brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t´u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t'u zgjedhur në KLP, KLGJ, KED, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, anëtarë të Gjykatës së Lartë, SPAK, BKH, Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe institucionet e tjera të paraqitura deri në këtë afat, 31 mars 2020.

Në referencë të problematikave të ndeshura, të trajtuara kryesisht në pikën 8 të këtij raporti dhe sa më sipër, ishte imediate nevoja për të ndërhyrë në dispozitat e ligjit tonë organik dhe në këtë kontekst, Autoriteti pas diskutimeve të këtyre ndryshimeve, i paraqiti organeve të legjislativit një Relacion shpjegues për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ku në mënyrë të qartë paraqitej problematika për çdo dispozitë që kërkohej ndryshimi, propozimi për ndryshim dhe impakti/synimi që kërkohej.

Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë me 95 vota pro, 10 kundër dhe 1 abstenim dhe botimi në Fletoren Zyrtare të ndryshimeve ligjore, me ligjin 114/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore

Socialiste të Shqipërisë", patën ndikimin e vet pozitiv në rregullimin e veprimtarisë së Autoritetit në zbatim të detyrave të ngarkuara nga ligji 45/2015 dhe praktikave të ndeshura gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të tij, për përmbushjen me sukses të misionit të tij dhe synonin:

1. Shmangien e problematikave të krijuara midis Autoritetit dhe institucioneve të tjera që administrojnë këto dokumente, gjatë procesit të dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit apo të lidhura me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjorë të nxjerra në këtë drejtim.
2. Qartësimin e terminologjisë ligjore në përkufizime të termit bashkëpunëtor, anëtar i ish-Sigurimit të Shtetit, unifikimin dhe harmonizimin me legjslacionin në fuqi në fushën e organeve te vetingut në drejtësi dhe polici, përafrimi i legjislacionit tonë me Konventën Ndërkombëtare të OKB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë;
3. Mosndërprerjen e procesit të verifikimit te pastërtisë së figurave të zyrtarëve në përgjithësi dhe në veçanti, të procesit të vetingut në polici, i cili është në hapat e parë të implementimit të tij, por njëherazi, vendosja e një afati kohor të caktuar sjell përmbushjen e qëllimit të kësaj dispozite ligjore.
4. Mosndërprerjen e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurave të të zgjedhurve në funksion të transparencës gjatë fushatave zgjedhore sipas llojit të zgjedhjeve, njëherazi mosvendosja e një afati kohor të caktuar lidhet direkt me moskufizimin e legjislatorit për moshën e të zgjedhurve në zgjedhjet e përgjithshme apo ato vendore.
5. Gjetjen e mënyrave të reja të bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe vendore në funksion të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të të zhdukurve ose të ekzekutuarve dhe vendvarrimeve të tyre;
6. Informimin në shkallë të gjerë, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, ku rol parësor kanë pasur strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, përmes aktiviteteve, botimeve, pjesëmarrjes në media dhe rrjete sociale, politikë kjo e kërkuar në vijueshmëri në Kuvend, përmes rezolutave.

AIDSSH gjen rastin dhe shpreh falënderimet për të gjitha institucionet që mbështetën nismën ligjore dhe dhanë kontribut të çmuar me opinione dhe propozime konkrete, në drejtim të miratimit të shtesave dhe ndryshimeve ligjore, aq të domosdoshme për realizimin e misionit të veprimtarisë së tij.

Së fundmi, në pikën 3 të nenit 22/1 "Bashkëpunimi për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve" të ligjit 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, legjislatori ka parashikuar se: "Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes

dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave". Në këtë kontekst referuar implementimit të dispozitës së sipërcituar, problematikës së krijuar në vijimësi të këtij procesi, sa delikat, aq dhe human, është parësor miratimi i këtij akti nga Këshilli i Ministrave, në të cilin duhet të pasqyrohen qartë detyrat e çdo institucioni që përfshihet në këtë proces. Autoriteti do të japë kontributin e vet në përgatitjen e një draft/akti, kryesisht në përcaktimin e detyrave të veta në këtë proces, por dhe më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qendore dhe vendore.

10

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT


Sekretar/e
i/e Kryetarit (1)
KRYETAR (1)
ANËTARËT
E AUTORITETIT (4)
Rrethi i Miqve
SEKRETARIATI TEKNIK
SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM [I-B]-1
DREJTORIA E ARKIVIT
(Total 10) Drejtor (II-B) -1
Sek. ruajtjes së fondeve
Përgjegj. Sektori (III-A) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Përpunimit
Përgjegj. Sektori (IIIA) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Dixhitalizimit dhe fotokopjes
Përgjegj. Sektori (IIIA) -1
Specialist (III-B) - 2
DREJTORIA E INFORMACIONIT
(Total 16) Drejtor (II-B) -1
Sek. Kërkesave individuale për informim
Përgjegj. Sektori (III-A) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Kërkesave individuale për qëllime rehabilitimi, dëmshpërblimi
Specialist (III-B) - 2
Sek. Kërkesave për informim nga institucionet
Përgjegj. Sektori (IIIA) -1
Specialist (III-B) - 2
DREJTORIA E MBËSHTETJES SHKENCORE DHE EDUKIMIT TË QYTETARËVE
(Total 6) Drejtor (II-B) -1
Sek. Projekteve studimore dhe audiovizuale
Përgjegj. Sektori (III-A) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Kërkesave për qëllime studimore, media, etj.
Specialist (III-B) - 2
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCAVE
(Total 15) Drejtor (II-B) -1
Sek. Burimeve njerëzore dhe Arkiv-Protokollit
Përgjegj. Sektori (III-A) -1
Specialist (III-B) - 1
Specialist (IV-B) - 2
Sek. Juridik dhe i Prokurorimeve
Përgjegj. Sektori (IIIA) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Financave
Përgjegj. Sektori (IIIA) -1
Specialist (III-B) - 1
Sek. Logjistikës dhe mirëmbajtjes
Përgjegj. Sektori (III-A/1) -1
Magazinier (K.P) 1
Pastrues (K.P) 2
Shofer (K.P) 1
DREJTORIA SIGURISË DHE ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
(Total 6) Drejtor (II-B) -1
Sek. Zhvillimit Teknologjik
Përgjegj. Sektori (III-A) -1
Specialist (III-B) - 2
Sek. Sigurisë fizike dhe qarkullimit të informacionit të klasifikuar
Specialist (III-B) - 2

10.1.Struktura dhe organika e Autoritetit

Vendimi i Kuvendit nr. 95, datë 22.12.2016, për strukturën dhe organikën përcakton që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit duhet të ketë një personel prej 60 punonjësish, ku 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; nr.79, nr.80, nr.81, nr.82, nr.83, datë 17.11.2016.

Në zbatim të nenit 39, pika 4 të Rregullores *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit",* miratuar me vendim të Autoritetit nr. 21, datë 09.05.2017 dhe të urdhrit të Kryetares së Autoritetit nr. 41, datë 24.05.2017 *"Për raportimin periodik të parashikimit dhe realizimit të veprimtarisë së Sekretariatit Teknik në AIDSSH"*, më poshtë puna e burimeve njerëzore dhe arkiv-protokollit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2020).

10.2. Burimet njerëzore

I.1 - Plani i rekrutimeve, procesi i rekrutimeve, për pozicionet e parashikuara në organigramën, strukturën e AIDSSH.

Në buxhetin e vitit 2020, Autoritetit iu vu në dispozicion një fond shtesë pagash që bënte të mundur plotësimin e organigramës, strukturës së AIDSSH me 10 punonjës të rinj.
Me vendimin nr. 727, datë 21.11.2019, ndryshuar me vendimin nr.435 datë 3.9.2020, Autoriteti aprovoi planin e detajuar të rekrutimeve për këta 10 punonjës për vitin 2020, përkatësisht tabela me poshtë:

Kategoria	Drejtoria	Sektori	Pozicioni	Nr. vakan-cave	Klasa
E ulët drejtuese	e Shërbimeve të brendshme dhe Financave	Sektori i Burimeve njerëzore dhe Arkiv-Protokollit	Përgjegjës	1	III-A
Ekzekutive	e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve	Sektori i Projekteve Studimore dhe Audiovizuale	Specialist	2	III-B
		Sektori i Kërkesave për qëllime Studimore, Media, etj.	Specialist	1	
	e Informacionit	Sektori i Kërkesave Individuale për Informim	Specialist	2	III-B
		Sektori i Kërkesave për Informim nga Institucionet	Specialist	1	III-B
	Shërbimeve të brendshme dhe Financave	Sektori Juridik dhe Prokurorimeve	Specialist	1	III-B
Kod Pune		Sektori i Logjistikës dhe Mirëmbajtjes	Magazinier	1	Kod Pune
			Pastrues	1	Kod Pune

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 pati lëvizje të nëpunësve ekzistues nëpërmjet dorëheqjeve, procedurave të lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë brenda institucionit apo në institucione të tjera, si rezultat i të cilave u krijuan vakanca në disa pozicione, pjesë të planeve të rekrutimeve të viteve 2017, 2018, 2019.
Bazuar në ligjin nr.152/2013 *"Për nëpunësin civil"* si dhe VKM nr.142, nr. 242, nr. 243, etj., udhëzimet e DAP dhe rregulloren e brendshme të Autoritetit, bazuar në planet e mësipërme të rekrutimeve, vakancave shtesë të krijuara gjatë vitit 2020, filluan dhe u kryen procedurat përkatëse, si hartimi, përditësimi, miratimi i përshkrimeve të punës, njoftimeve përkatëse për konkurim dhe shpalljeve publike, verifikimeve paraprake dhe përzgjedhja e kandidatëve të kualifikuar, zhvillimi i testimeve përkatëse dhe vlerësimet e rezultateve të testimeve; marrja e vendimeve për kandidatin fitues dhe njoftimet e publikimet përkatëse, etj. Shkalla reale e plotësimit të drejtorive/sektorëve të Autoritetit, me punonjës për të cilët ka fond pagash, në fund të vitit 2020, krahasuar me numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin e Kuvendit nr.95/2016, jepet në tabelën në faqen tjetër.

Në buxhetin e vitit 2021 është parashikuar një fond pagash shtesë për Autoritetin, që do të bëjë të mundur rekrutimin e 10 punonjësve të rinj dhe plotësimin e plotë të organigramës, strukturës së AIDSSH, sikurse është miratur me Vendimin e Kuvendit nr.95/2016.

I.1.2 – Punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme

Me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 22.1.2020 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore", Autoritetit iu dha e drejta të punësonte 4 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme, përkatësisht në pozicionet:

- 1 (një) teknik mirëmbajtje;
- 1 (një) operator
- 2 (dy) punonjës arkive

I.1.3 – Puna vullnetare pranë Autoritetit.

Gjatë vitit 2020 në përgjigje të kërkesave të ardhura për punë vullnetare pranë Autoritetit janë zhvilluar të gjithë procedurat dhe është plotësuar dokumentacioni përkatës për kryerjen e punës vullnetare pranë Autoritetit për 7 (shtatë) persona, për një periudhë mesatare 3 (tre) – 6 (gjashtë) mujore.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të "Programit Kombëtar të Praktikave të Punës", të iniciuar, drejtuar dhe udhëhequr nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, u realizua bashkëpunimi me këtë Ministri për identifikimin, ndjekjen dhe plotësimin e të gjithë procedurave dhe dokumentacionit përkatës për kryerjen e praktikës pranë Autoritetit nga ana e 4 praktikantëve për një periudhë 3 (tre) mujore.

Njësite, emërtimet e njësive, sipas Organogramës		Sektori	Pozicioni	Nr.punonjësve sipas organikës		Nr.punonjësve me fond page deri fund 2020		Nr.Total i punonjësve të rekrutuar deri Dhjetor 2020		Nr.punonjësve, me fond page, për rekrutim, ne vitin 2021	% reale e rekrutimeve sipas organikës
Autoriteti	Autoriteti		Anetar	5	5	5	5	4	4	1	80.0%
	Sekretaria e Kryetares		Sekretare	1	1	1	1	1	1		100.0%
Sekretariati Teknik	Sekretariati Teknik		Sekretar i Pergjithshem	1	1	1	1	1	1		100.0%
	Drejtoria e Informacionit		Drejtor	16	1	1	11	1	11		68.8%
		Sektori i Kërkesave Individuale për Informim	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		9	5		5			
		Sektori Kërkesave për Informim nga Institucionet	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		2	2		2			
		Sektori i Kërkesave për Qëllime Rehabilitimi dhe Dëmshpërblimi	Specialist		2	1		1			
	Drejtoria e Arkivit		Drejtor	10	1	1	9	1	8		80.0%
		Sektori i Ruajtjes së Fondeve	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		2	2		2			
		Sektori i Përpunimit	Përgjegjës		1	1		0		1	
			Specialist		2	2		2			
		Sektori i Dixhitalizimit dhe Fotokopjes	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		2	1		1			
	Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve		Drejtor	6	1	1	6	1	6		100.0%
		Sektori i Projekteve Studimore dhe Audiovizuale	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		2	2		2			
		Sektori i Kërkesave për Qëllime Studimore, Media etj	Specialist		2	2		2			
	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financave		Drejtor	15	1	1	13	0	11	1	73.3%
		Sektori i Financave	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		1	1		1			
		Sektori Juridik dhe Prokurimeve	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist Prokurimeve		1	1		1			
			Specialist Juridik		1	1		1			
		Sektori i Burimeve Njerëzore	Pergjegjes		1	1		1			
			Specialist, Bur.Njerez.		1	1		1			
			Specialist, Arkiv-Protok.		2	1		1			
		Sektori i Logjistikës dhe Mirëmbajtjes	Përgjegjës		1	1		1			
			Magazinier		1	1				1	
			Shofer		1	1		1			
			Sanitare		2	1		1			
	Drejtoria e Sigurisë dhe Zhvillimit Teknologjik		Drejtor	6	1	1	4	1	4		66.7%
		Sektori i Zhvillimit Teknologjik	Përgjegjës		1	1		1			
			Specialist		2	1		1			
		Sektori i Sigurisë Fizike dhe Qarkullimit të Informacionit të Klasifikuar	Specialist		2	1		1			
				60		50		46		4	76.7%

I.2 – Trajnimet e punonjësve

Si rezultat i pandemisë COVID-19, për shkak të masava të distancimit social ka qenë i vështirë realizimi i trajnimeve të planifikuara. Gjithsesi, gjatë vitit 2020 në bashkëpunim me ASPA, DSIK, MF, ILDKPIK dhe institucione të tjera, janë kryer online një pjesë e mirë e trajnimeve të planifikuara.

Konkretisht, një pasqyrë me temat e trajnimeve të kryera, institucionet trajnuese dhe numrin e punonjësve pjesëmarrës për çdo temë trajnimi të kryer, jepet në tabelën e mëposhtme:

Gjithashtu gjatë vitit 2020, kryen dhe përfunduan trajnimin e detyrueshëm dyjavor pranë ASPA, "Prezantimi me Administratën Publike", duke kaluar me sukses edhe testin përkatës, 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, të emëruar nëpunës civilë në periudhë prove. Të gjithë këta punonjës kanë kryer testin përkatës pranë ASPA në përfundim të periudhës së provës.

Për 5 (pesë) punonjës, për të cilët kanë ardhur rezultatet e testit të kryer, janë realizuar të gjitha procedurat përkatëse dhe bazuar në vlerësimin në punë për periudhën 1-vjeçare të provës dhe rezultateve të testit, të pesë punonjësit janë konfirmuar si nëpunës civilë.

Nr.Temave	Pershkrimi/Temat e trajnimit	Nr.Punonj. pjesemarr.	Institucioni trajnues
1	"(Pa)ligjshmëria dhe (pa)vlefshmëria e aktit administrativ"	1	ASPA
2	"(Pa)ligjshmëria e Aktit Administrativ"	2	ASPA
3	"Akti Administrativ II"	1	ASPA
4	"Deklarimi i pasurisë, llojet dhe mënyra e plotësimit të tyre"	1	ASPA
5	"Gramatika për hartimin e aktit ligjor"	1	ASPA
6	"Hartimi i legjislacionit, roli i hartuesit dhe interpretimi"	1	ASPA
7	"Hierarkia e normave dhe perzgjedhja e llojit te aktit ligjor qe do te hartohet",	1	ASPA
8	"Komunikimi"	1	ASPA
9	"Korrupsioni: ves apo tundim"	1	ASPA
10	"Marredheniet Nderkombetare"	1	ASPA
11	"Parimit e Mirëqeverisjes - Qeverisja përmes sundimit të ligjit, kompetencave dhe inovacionit"	1	ASPA
12	"Planifikimi buxhetor afatmesëm dhe monitorimi"	3	ASPA
13	"Procedimi disiplinor në Shërbimin Civil "	1	ASPA
14	"Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit"	1	ASPA
15	"Sinjalizimi dhe mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizuesve-udhërrëfyesi për nëpunësit e administratës publike"	1	ASPA
16	"Teknikat e strukturimit të aktit ligjor"	1	ASPA
17	"Teknologjia në mbështetje të punës në distancë"	1	ASPA
18	"Vleresimi i performances"	1	ASPA
19	"Zhvillimi i Drejtësisë Penale Ndërkombëtare nga Tribunali i Nurembergut deri në Themelimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare"	1	ASPA
20	"Bazat në statistikë"	1	ASPA
21	"E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale".	5	ASPA
22	"Hartimi i legjislacionit"	1	ASPA
23	"Kodi i Procedurave Administrative"	1	ASPA
24	"Menaxhimi i Fondeve te BE"	1	ASPA
25	"Ndalimi i diskriminimit dhe barra e provës në administratën publike"	1	ASPA
26	"Parandalimi i konfliktit të interesit"	1	ASPA
27	Informacionet që kufizohen nga e drejta për informim	2	ASPA
28	Perpunimi tekniko-shkencor i dokumneteve"	2	ASPA
29	Si të ngre një strategji për zhvillimin personal, gjatë eksperiencës së punës në Administratën Publike	1	ASPA
30	Webinari "Google Drive for Work",	1	ASPA

Për 6 (gjashtë) punonjësit e tjerë janë kryer vlerësimet në punë në përfundim të periudhës 1-vjeçare të provës dhe, me të ardhur rezultatet e testit do të kryhen procedurat përkatëse për konfirmimin ose jo të tyre si nëpunës civilë.

10.3. Arkiv-Protokolli

I.1-Në mënyrë të përmbledhur, gjatë vitit 2020:

1. Është kryer administrimi i dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të institucionit, duke zbatuar sisteme dhe procedura të qarta dhe të sigurta të protokollimit dhe arkivimit të tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloren e brendshme të AIDSSH-së;
2. Është kryer administrimi dhe ruajtja e vulave dhe e dokumenteve të regjistruara (hyrëse dhe dalëse) pranë sekretarisë së institucionit, Kontrolli i zbatimit të kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti;
3. Zyra e Protokoll-arkivit ka udhëzuar, ndihmuar të gjithë sektorët, personelin e Autoritetit për sistemin dhe procedurat e nevojshme për përdorimin e dokumentacionit, materialeve që janë prodhuar apo që kanë ardhur në Autoritet dhe që janë protokolluar dhe arkivuar;
4. Është bërë hapja e dosjeve sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre, dhe vazhdon procesi për vendosjen dhe sistemimin e dokumenteve që krijohen gjatë vitit në dosjet përkatëse;
5. Është ngritur Komisioni i Ekspertizës, i cili ka miratuar listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve;
6. Është hartuar urdhri për njësimin e dokumentit administrativ në AIDSSH, urdhër nr.2, datë 07.01.2020. Shkresat që sillen në protokoll për t'u regjistruar kanë mungesa të elementeve që parashtrohen në këtë urdhër;
7. Për shkresat e klasifikuara për vitet 2017-2018-2019 është krijuar një inventar elektronik;
8. Është administruar regjistri i mbledhjeve të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH). Për çdo mbledhje është kryer dërgimi i bilbliografive me shkresave përkatëse përcjellëse në DSIK dhe skanimi/dërgim i bibliografisë me email në Drejtorinë e Arkivit;
9. Për shkak të gjendjes së Covid-19, procese, si vendosja në dispozicion të praktikave të reja për trajtim, shfrytëzimi i arkivit, kalimi i korrespondencës së brendshme është realizuar nëpërmjet postës elektronike.
10. Është krijuar inventari elektronik për shkresat e klasifikuara për vitet 2017-2018-2019, 2020;
11. Vazhdon krijimi i inventarit elektronik për regjistrat e korrespondencës së zakonshme për vitet 2017, 2018, 2019, 2020;
12. Krijimi i inventarit elektronik të urdhrave të brendshëm për vitet 2017/ 2018/ 2019./ 2020;
13. Administrimi i postës elektronike, adresa: info@autoritetidosjeve.gov.al

I.2-Në mënyrë skematike:



1.4. **Veprimtaria në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të ligjit për kontrollin e interesit, pjesë e Autoritetit Përgjegjës të AIDSSH**

1. Hartimi i raportit vjetor 2019 dhe dërgimi brenda afateve ligjore të raportit në ILDKPKI.
2. Njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, para fillimit në detyrë dhe pas largimit nga funksioni të subjekteve deklaruese të institucionit.
3. Rakordimi i listës së subjekteve midis institucionit të AIDSSH dhe ILDKPKI-së.
4. Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të udhëzimit për autoritetet përgjegjëse, me qëllim vënien në dispozicion institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI.
5. Ndjekja brenda të gjitha afateve ligjore dhe me të gjithë hapat e duhur, të konfliktit të interesit rast pas rasti të specialistes së Sektorit të Ruajtjes së Fondeve të Drejtorisë së Arkivit, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon ILDKPI.
6. Dorëzimi brenda afateve ligjore të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të të gjitha subjekteve deklaruese të AIDSSH.
7. Ndjekja e një rasti tjetër të konfliktit të interesit i cili, rast pas rasti ka deklaruar konflikt në çështjet që kanë të bëjnë me punën e tij, që është rasti i Drejtorit të Informacionit, që i ka deklaruar me gojë dhe sipas një konsultimi me autoritetin përgjegjës të ILDKPI-se nuk rezultoi konflikt i vazhdueshëm, edhe pse nuk ishte deklaruar në formën ligjore të duhur.
8. Në katërmujorin e dytë të këtij viti, autoriteti përgjegjës për konfliktin e interesit nuk ka pasur veprimtari.

1.5. Të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet e Autoritetit

AIDSSH, për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, ka punuar në mbështetje të legjislacionit në këtë fushë, si dhe në:

- Mbështetje në fondet buxhetore për realizimin e qëllimit kryesor të AIDSSH-së, informimin në bazë të kërkesave të subjekteve përkatëse, target grup i fushës së veprimit të ligjit 45/2015, i ndryshuar....
- Mbështetje në fondet buxhetore për rritjen e performancës së personelit nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.
- Mbështetje në fondet buxhetore për anëtarësimin në organizmat ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara prej tyre.
- Mbështetje në fondet buxhetore për mbarëvajtjen e punës në AIDSSH,

si dhe:

- ka ndjekur në mënyrë sistematike realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të institucionit, të ndara në periudha kohore;
- ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) të institucionit;
- ka parashikuar realizimin e fondeve të prokuruar dhe vlerësimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit të organizuara nga institucioni, duke përfshirë llogaritjen e fondeve limit dhe vlerësimin e ofertave ekonomike në procedurat e prokurimit publik;
- ka siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktiveve në pronësi të institucionit.

Për vitin 2020, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:



Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2020	Buxheti me ndryshimet Viti 2020	Realizimi faktik 2020	
				Në vlerë	Në %
1	**Planifikim-Menaxhim-Administrim**	83 000	78 000	56 661	72.6%

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2020, jepet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Llog	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2020	Buxheti me ndryshimet Viti 2020	Realizimi faktik Viti 2020	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	59 500	51 300	39 965	77.9%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	4 500	9 700	6 318	65.1%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	18 000	16 000	9 617	60.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	1 000	1 000	882	88.2%
	T o t a l i	**83 000**	**78 000**	**63 361**	**81.2%**



➢ **<u>Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime</u> (zëri 602 -606) për periudhën 12 –mujore 2020,**

është realizuar për:

- Shpenzime për kancelari, 672 154 lekë
- Kuti dhe dosje speciale, në vlerën 3 405 600 lekë.
- Materiale për pastrim, dezinfektim, në vlerën 295 848 lekë.
- Blerje tonerësh, në vlerën 700 800 lekë.
- Uniforma dhe veshje speciale për arkivin, në vlerën 731 880 lekë.
- Shpenzime për energji elektrike dhe ujë, respektivisht 1 610 690 lekë dhe 147 960 lekë
- Janë likuiduar faturat për shërbimin e internetit sipas kontratës në vlerën 111 600 lekë.
- Shpenzime postare sipas kontratës së lidhur me Postën Shqiptare, në vlerën 89 630 lekë.
- Shpenzime transporti për taksa, transport nga të tretët dhe siguracion të automjeteve, në vlerën 72 523 mijë lekë.
- Shpenzime në funksion të realizimit të aktiviteteve të Autoritetit për printime banera, në vlerën 58 200 lekë.
- Për udhëtime, fondi total i shpenzuar është 671 333 lekë, nga të cilat:
- 1. Dieta në vlerën 367 577 lekë
- 2. Bileta në vlerën 303 756 lekë.
- Mirëmbajtje programi Alpha, në vlerën 117 847 lekë.
- Mirëmbajtje pajisje kompjuterike, në vlerën 69 285 lekë.
- Shpenzime për honorare, ku përfshihen pagesat e pedagogëve që marrin pjesë në komisionet e rekrutimit të punonjësve



të rrinj në vlerën 164 000 lekë.

- Shpenzime përkthimi në vlerën 269 079 lekë.
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca në vlerën 698 640 lekë.

➢ Shpenzimet kapitale në vlerën 882 240 lekë ku fondi prej 744 480 lekë janë blerë pajisje kompjuterike, 110 160 lekë janë blerë pajisje zyre dhe 27 600 lekë janë shpenzuar për kolaudimin e punimeve të godinës.

Gjithashtu, është ndjekur në vijimësi realizimi i financimit nga Ambasada Suedeze **për projektin "**Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne", treguesit e së cilës janë sipas tabelës së mëposhtme:

Llogaria	Në Lek
600	865,971.00
601	396,351.00
602	4,400.00
231	14,883,544.00
TOTALI	**16,150,266.00**

1.6. Prokurimet

Në funksion të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2020, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimeve për vitin 2020, në të cilin, në bazë të buxhetit të miratuar nga Ministria e Finanacave dhe Ekonomisë për Autoritetin, për vitin 2020 janë parashikuar procedura prokurimi për shërbime e mallra të domosdoshme dhe të nevojshme për veprimtarinë e Autoritetit, që nga blerja e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjet e zyrave, deri te materialet për pastrim dhe dezinfektim e shërbimet e internetit, dezinfektimit të mjediseve të Autoritetit, diktuar nga kushtet e përhapjes së pandemisë Covid 19.

Procedura të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2020 kanë qenë rikonstruksioni i godinës së re të Autoritetit, i shoqëruar me procedurën e mbikëqyrjes së punimeve të rikonstruksionit, si dhe blerje dhe montim raftesh për arkivin e ri, etj., procedura të realizuara me fondet e SIDA-s, Ambasada Suedeze.

Vlen të përmendet që të gjitha procedurat e prokuruara, të realizuara, apo jo, janë kryer në mënyrë transparente dhe me integritet të plotë nga njësitë e prokurimit dhe te komisionet e vlerësimit të ofertave, komisionet e shqyrtimit të ankesave dhe të marrjes në dorëzim, komisione të përbëra nga punonjës të të gjitha drejtorive dhe sektorëve të Autoritetit, të koordinuara nga SJP.

E përkthyer në shifra, Regjistri i Parashikimeve i Autoritetit për vitin 2020 ka qenë në një total prej 12 895 883 lekësh, nga të cilat janë realizuar procedura që përmbajnl shifren prej 9 153 421 lekësh.

10.7.Logjistika

Gjatë vitit 2020, është mundësuar mirëfunksionimi i punës në Autoritet, duke garantuar gatishmërinë e sistemit elektrik, hidraulik dhe elektromekanik në ambientin e punës. Gjatë muajve janar, shkurt 2020, është konstatuar mbingarkimi i rrjetit elektrik i godinës ku ushtron aktivitet Autoriteti, pasi në të njëjtin kontaktor të energjisë elektrike janë instaluar edhe institucione të tjera shtetërore, duke shkaktuar mbingarkesë të rrjetit elektrik, si dhe ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike. Kjo e shoqëruar edhe me fatura të larta të konsumit të energjisë elektrike, të cilat janë paguar nga Autoriteti. Për zgjidhjen e këtij problemi ka pasur kontakte të vazhdueshme, si dhe janë dërguar shkresa zyrtare, në periudhën (shkurt-mars) pranë institucioneve përkatëse, si dhe në OSHEE, ku është kërkuar shkëputja e institucioneve të tjera nga kontatori i Autoritetit. Deri tani problemi është zgjidhur pjesërisht, pasi situata e pandemisë nuk ka mundësuar vazhdimin normal të ndjekjes së problemit.

Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm për magazinimin e materialeve, në ambientin aktual ku punon Autoriteti pa standardet e rekomanduara në udhëzimet përkatëse, dëmton cilësinë e materialeve. Gjithashtu, depozitimi i disa materialeve në godinën aktuale dhe disa në godinën e re ka vonuar plotësimin në kohë të nevojave të punonjësve me artikuj.

Bazuar në nevojat dhe eksperiencat e viteve të mëparshme janë blerë përgjatë vitit 2020, artikuj kancelarie, mjete pastrimi, tre kompjuterë dhe një lente skaneri, të cilat i janë shpërndarë stafit të Autoritetit, bazuar në kërkesat dhe miratimet përkatëse. Vlen të theksohet se numri i kërkesave sipas nevojës së punonjësve të administratës për pajisjen me kompjuter është në raport të zhdrejtë me numrin aktual të kompjuterëve.

Në mbështetje të VKM nr. 243, datë 24.03.2020 dhe vendimit nr. 200, datë 6.04.2020 i AIDSSH "Për miratimin e udhëzimit të planit të masave organizative dhe administrative nga AIDSSH në kushtet e epidemisë së Covid-19", janë kryer procedurat e prokurimeve mbi bazën e kërkesave për dezinfektimin e mjediseve të brendshme të AIDSSH, blerjen e maskave dhe dezinfektantëve për stafin, blerjen e aparatit të matjes së temperaturës, vendosjen e xhamit mbrojtës te recepsioni.

Në muajin shkurt 2020 është bërë kalimi i kapitalit pa pagesë për 25 artikuj: tavolina, karrige, orendi zyre, etj., që i janë dhuruar AIDSSH-së nga Garda e Republikës, referuar urdhrit të përbashkët nr. 36/1, datë 13.02.2020, ndërmjet palëve, artikuj të përfshirë në listën e aseteve të institucionit, që nga data e marrjes në dorëzim.

11. PROCESET GJYQËSORE KU INSTITUCIONI KA QENË PALË NË PROCES

Proceset gjyqësore ku institucioni ka qenë palë në proces

Nr.	Paditës	Faza e procesit	Komente
1	S. V.	Në proces gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.	Çështja gjyqësore me kërkues S.V. me Autoritetin, i cili është thirrur në këtë gjykim në cilësinë e personit të tretë, plotësuar prapësimet dhe ndjekur çështja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; çështja ka përfunduar, pasi dhe me kërkesën e kërkuesit S.V., është përcjellë për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
		Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.	Përgatitur prapësimet dhe pjesëmarrje në seancë në çështjen gjyqësore me palë S.V. dhe Autoritetin. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, duke konstatuar moskompetencë, e ka përcjellë çështjen në Gjykatën e Lartë, për të përcaktuar kompetencën ligjore. Pritet vendimi i Gjykatës së Lartë.
2	L. K.	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Përgatitur prapësimet, pjesëmarrje në seancën gjyqësore për çështjen gjyqësore me palë paditëse L.K., pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Përfaqësuesi në gjykim i L.K. nuk kërkoi shfuqizimin e vendimit administrativ të Autoritetit, pasi mendonte që Autoriteti ka marrë vendim korrekt, pasi është vendim informues mbi atë çka është gjetur, por paditësi kërkon fshirjen nga fleta e regjistrit të agjenturës të rreshtit ku është regjistruar paditësi. Pala jonë, pasi kundërshtoi që nuk mund ishte e palë e paditur për fshirjen e një dokumenti autentik të një institucioni që nuk ekziston më, e la në çmim të gjykatës të vendoste. Meqenëse çështja nuk kishte më karakter administrativ, gjyqtarja shpalli moskompetencë ligjore të Gjykatës Administrative dhe i përcolli aktet në Gjykatën Civile, pasi çështja merr karakter civil. Çështja në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, ka përfunduar dhe jemi në pritje se si do të procedohet nga Gjykata Civile e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Në dhjetor 2019, është zhvilluar seanca përgatitore pranë kësaj gjykate, ku janë lënë disa detyra për paditësin. Janë zhvilluar dhe dy seanca të tjera, ku paditësi s'ka paraqitur asnjë argument.

3	**G. Z.**	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Përgatitur prapësimet për Gjykatën Administrative të Rrethit Tiranë, për çështjen administrative me palë: paditës G.Z. dhe i paditur Autoriteti, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme të vendimit nr. 593, datë 04.10.2019, si dhe korrigjimin e vendimit nr. 333, datë 24.05.2019, marrë nga Autoriteti. Në muajin dhjetor është zhvilluar pranë Gjykatës Administrative seanca përgatitore, secila nga palët ka paraqitur pretendimet dhe prapësimet në mënyrë të përmbledhur. Nga ana e palës së paditur është paraqitur kërkesa për thirrjen si palë e tretë në gjykim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kërkesa nuk është pranuar nga ana e Gjykatës. Seanca e radhës u zhvillua më 17 shkurt 2020. Me vendim, Gjykata vendosi rrëzimin e padisë. Më pas, pala paditëse G.Z. ka apeluar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, ndërsa AIDSSH, si palë e paditur, ka dërguar prapësimet po në këtë Gjykatë. Pritet të caktohet data e shqyrtimit të apelimit.
4	**Xh. Sh.**	Proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.	Përgatitje e deklaratës së mbrojtjes për procesin gjyqësor, çështjen civile me palë kërkuese Xh.Sh., person i tretë - AIDSSH, me objekt vërtetimin gjyqësor të faktit që Komisioni Shtetëror i ngritur në zbatim të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", i ndryshuar, ka lëshuar për kërkuesin Xh. Sh. dëshminë e verifikimit, nga ku vërtetohet se ky i fundit nuk është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike të përcaktuara në ligjin në fjalë për funksionin e Drejtorit të Policisë Kriminale, të mbajtur nga kërkuesi, për periudhën objekt verifikimi nga ana e Komisionit Shtetëror. Më datë 30.01.2020 u zhvillua seanca përgatitore pranë Gjykatës së Rrethit, ku secila nga palët paraqiti shpjegimet dhe prapësimet e veta. Nga ana e Gjykatës u la detyrë për palën kërkuese të provonte faktin e qenies si zyrtar i verifikuar nga ana e Komisionit. Jemi në pritje të datës së zhvillimit të procesit gjyqësor. Në seancën e radhës u vendos nga Gjykata kthimi në institucion i shkresave:

			1. Shkresa nr. 889/1, datë 23.05.2017 e SHISH (4 faqe) 2. Shkresa nr. prot. 1856, datë 22.07.1999 e SHISH (1 faqe) 3. Shkresa nr. prot. 229, datë 11.02.1999 e Komisionit "Bezhani" (të dyja kopjet, qoftë ajo me gjeneralitetet e babait, F., qoftë shkresa pa gjeneralitetet) (2 faqe) 4. Shkresa nr. prot. 1982, datë 07.07.1998 e Ministrisë së Rendit Publik (2 faqe). Pala kërkuese paraqiti tre dokumente për të mbështetur pretendimet e veta dhe gjithashtu, kërkoi verifikimin e qenies në dispozicion në Autoritetit të dy dokumenteve të përdorura, sipas tij, nga Komisioni "Bezhani" në punën e vet si komision. Për të lejuar kohë për të bërë këto verifikime dhe për të vijuar me shpjegimet e secilës palë, Gjykata caktoi datën 8 shtator për seancën e radhës. Ndërkohë, më datën 27 korrik, ora 09.00, gjyqtarja dhe kërkuesi u paraqitën në Autoritet për të këqyrur dokumentacionin që lidhet me Komisionin "Bezhani". Pas kësaj janë zhvilluar disa seanca, ku palët kanë mbrojtur provat përkatëse dhe ku kërkuesi, në njërën prej seancave ka thirrur dy dëshmitarë të dëshmojnë mbi objektin e kërkimit. Gjithashtu, kërkuesi ka bërë kërkesë për dy dokumente, pasi mendon që shërbejnë për objektin, kërkesa ka kaluar në Autoritet, është miratuar, i është dorëzuar kërkuesit dhe Gjykatës. Çështja vazhdon.
5	**E. M.**	Përfunduar gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Gjykata, më datë 12.10.2020, vendosi pushimin e gjykimit të çështjes administrative me nr. 3266 (31154-03088-80-2020) Regj., dhe Themel nr.2321(80-2020-2339) me paditës E. M. dhe palë të paditur Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me objekt: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, vendimit nr. 175, datë 24.3.2020, të AIDSSH; Vërtetimin e faktit juridik të mosbashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit. Pala paditëse, z. E. M. ka bërë ankim të veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku kërkon rikthimin e gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6	**D. M.**	Përfunduar gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Përgatitur prapësimet, pjesëmarrje në seanca gjyqësore për çështjen gjyqësore me palë paditëse D.M., pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; Paditësja, në padinë e saj kundër Autoritetit kërkonte shfuqizimin e vendimit nr. 475, datë 18.9.2020 të Autoritetit dhe detyrimin e palës së paditur për pajisjen me dosjen që i përket babait të saj të ndjerë, M.R. Gjykata, më datë 14.12.2020 vendosi rrëzimin e padisë së paditëses D.M., si të pambështetur në ligj dhe në prova.
7	**F. H.**	Padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Përgatitur prapësimet për objektin e padisë: shfuqizim i vendimit nr. 340, datë 22.06.2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të dërguara në Gjykatë. Pritet data e seancës.
8	**A.G.**	Në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i ka dërguar Autoritetit njoftimin e kërkesë-padisë dhe akteve shoqëruese, me nr. regj., them., 4418, protokolluar në Autoritet me nr. 1779/6, datë 1.12.2020. Paditësi kërkon "Shfuqizimin e vendimit nr. 472, datë 18.9.2020 të Autoritetit dhe detyrimin e organit publik (AIDSSH) që të japë informacionin e kërkuar dhe kopje të dokumentacionit që provon të ketë informacion sipas kërkesës së shtetasit A. G., pranuar dhe protokolluar me nr. prot. 1779, datë 26.12.2019, në këtë organ." Janë përgatitur prapësimet dhe janë paraqitur në Gjykatë me shkresën nr. prot. 1779/7, datë 10.12.2020. Në pritje të caktimit të datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT